



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 535 Akti

Nr. 647 Vendimi
Tiranë, më 14.4.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Firdes Shuli	Relatore
Xhensila Pine	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Ertugena Sokoli, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datat 12.4.2023 dhe 14.4.2023, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Izabela Radovani**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Izabela Radovani, e cila në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Znj. Izabela Radovani është subjekt i rivlerësimit sipas nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), për shkak të funksionit të saj si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

2. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, është zhvilluar shorti në datën 15.6.2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Izabela Radovani do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Olsi Komici, Firdes Shuli dhe Xhensila Pine. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016.

3. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: (i) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31-33 të ligjit nr. 84/2016; (ii) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; (iii) Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Me vendimin nr. 1, datë 22.6.2020, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Izabela Radovani, duke u bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuesin e trupit gjykues, komisioner Olsi Komici. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit. Subjekti deklaroi në rrugë elektronike se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

5. Me vendimin nr. 2, datë 9.3.2023, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh prej relatores së çështjes me rezultatet e hetimit dhe me provat e grumbulluara për të tria kriteret, vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Izabela Radovani; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t’u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

6. Në datën 10.3.2023, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit administrativ për të tria kriteret; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të dhënë sqarime mbi konstatimet e Komisionit, jo më vonë se data 30.3.2023; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Në datën 20.3.2023 subjekti i rivlerësimit ka marrë kopje të akteve të dosjes nëpërmjet përfaqësuesit, shtetasi G. R., sipas prokurës së posaçme nr. ***, datë 18.3.2023.

8. Në datën 29.3.2023 me anë të postës elektronike, subjekti i rivlerësimit kërkoi shtyrjen e afatit për paraqitjen e parashtrimeve dhe provave. Po në këtë datë, me anë të postës elektronike, subjekti u njoftua nga trupi gjykues për vendimin nr. 3, datë 29.3.2023, me anë të të cilit pranohej kërkesa e saj, duke e shtyrë afatin për dorëzimin e parashtrimeve dhe dokumentacionit deri në datën 4.4.2023.

9. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion elektronikisht nga subjekti në datën 4.4.2023 dhe fizikisht protokolluar në datën 5.4.2023, me vendimin nr. 4, datë 6.4.2023, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin në seancë dëgjimore.

10. Në datën 12.4.2023 u zhvillua seanca dëgjimore, në të cilën subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm dhe, në përfundim, kërkoi konfirmimin në detyrë.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

11. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

12. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

13. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin në lidhje me kontrollin e figurës. Sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

14. Referuar vendimit nr. 2/201721 të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse, bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, duke marrë në analizë: (i) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe dokumentet shkresore të vëna në dispozicion nga ky institucion vlerësimi; (ii) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar nga DSIK-ja dhe dokumentet shkresore të vëna në dispozicion nga ky institucion vlerësimi; (iii) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja dhe dokumentet shkresore të paraqitura prej tyre; (iv) provat shkresore/dokumentet e vëna në dispozicion nga institucionet apo subjektet publike a private; (v) denoncimet e publikut sipas nenit 53 të ligjit dhe çdo informacion të marrë në rrugë ligjore; (vi) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit; (vii) sugjerime/opinione të vëzhguesit të ONM-së sipas nenit 49, pikat 10-12 të ligjit.

III. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

Vlerësimi i pasurisë

15. Në zbatim të nenit 31/1 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Izabela Radovani ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratën e pasurisë në datën 27.1.2017, pra, në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në referencë të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, znj. Izabela Radovani është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, kur ka dorëzuar deklaratën përpara fillimit të detyrës (në vijim DPF) me nr. indeksi *** dhe në vijim, ka dorëzuar rregullisht deklaratat periodike vjetore (në vijim DPV).

16. ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për subjektin Izabela Radovani, ka konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka mungesë të dokumentacionit ligjor për të justifikuar burimin financiar të pasurive; (iii) ka mosdeklarime të pasurive; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

17. Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurinë e subjektit të rivlerësimit Izabela Radovani, si dhe të personave të lidhur me të.

18. Hetimi administrativ në lidhje me rivlerësimin e pasurisë konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën *Vetting*; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklarimeve të rreme; si dhe (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim vërtetimin ose jo të deklarimeve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

19. *Shtëpi banimi, apartament, me sip. 76 m², nr. pasurie ***, z.k. ***, adresa: lagjja “***”, rruga “***”, p. nr. ***, Shkodër. Pronësi e fituar me akt dhurimi në datën 15.12.1998, në fakt paguar vlera 500.000 lekë (të ardhura të përbashkëta) dhe e regjistruar në emrin e bashkëshortit, bashkëngjitur dokumentacioni përkatës. Vlera: 500.000 lekë. Pjesa takuese: 50 %.*

20. ILDKPKI-ja ka konstatuar mospërputhje lidhur me mënyrën e përfitimit të apartamentit me sip. 76 m², në Shkodër, në vitin 1998, si dhe vlerën e paguar, pasi në deklaratën “Para fillimit të detyrës 2003” është deklaruar vlera e blerjes 1.800.000 lekë dhe në deklaratën e pasurisë *Vetting*, deklaruar se është përfituar me akt dhurimi, por paguar 500.000 lekë. Rezulton në ZVRPP Shkodër, se kjo pasuri është përfituar me akt dhurimi. Gjithashtu, ka konstatuar mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin financiar për krijimin e pasurive me vlerë rreth 4.650.000 lekë në DPFD 2003.

21. Gjatë hetimit administrativ, nga aktet në dosje¹ rezulton se:

- ASHK Shkodër ka konfirmuar pasurinë nr. ***, të llojit “apartament” me sip. 76 m², në pronësi të shtetasit K. R.

- FSHU-ja nuk ka konfirmuar të ketë kontratë të lidhur me subjektin dhe personat e lidhur me të në këtë adresë. Subjekti ka paraqitur librezën e energjisë elektrike për kontratën me nr.***, si dhe librezën e energjisë elektrike për kontratën me nr. ***, të dyja në emër të shtetasit L. R., vjehri i subjektit². Dy kontratat i përkasin përkatësisht apartamentit objekt verifikimi dhe apartamentit në pronësi të babait të subjektit, bashkuar në një të vetëm në apartamentin me sip. 151 m², me adresë lagjja “***”, p. nr. ***, të cilin subjekti e ka deklaruar në vijimësi si adresë banimi (trajtuar në vijim).

22. Komisioni kreu verifikimin e të dhënave të FSHU-së, nga ku rezultoi se: (i) për kontratën nr. *** vërehet se nga janari 2007 dhe aktualisht ka faturime aforfe në vlerat të vogla, me përjashtim të muajve korrik-gusht-shtator 2022; (ii) për kontratën me nr. ***, në periudhën janar 2007 – shtator 2013 ka faturime të konsumit të energjisë elektrike që variojnë në vlera të ndryshme, ndërsa nga shtatori 2013 deri në korrik 2021 rezultojnë faturime aforfe në vlera të vogla. Pas kësaj periudhe e deri sot, vërehet e njëjta situatë me përjashtim të 6 muajve ku vërehet konsum i energjisë elektrike.

23. Siç vërehet nga të dhënat e FSHU-së, shpenzimet e energjisë elektrike në të dyja kontratat nuk janë të tilla që të vërtetojnë përdorimin e pasurive në mënyrë të vijueshme, pasi në pjesën më të madhe të kohës pagesat janë në vlera aforfe ose të pakonsiderueshme, ndërsa nga shtatori 2013 deri në korrik 2021 nuk ka fare shpenzime për të dyja kontratat me përjashtim të muajve korrik-gusht-shtator 2022 për kontratën ***. Në këto kushte është e paqartë përse nuk ka

¹ Shihni Aneks 4/2 dhe Aneks 28 në dosjen ILDKPKI dhe dokumentet e paraqitura në pyetëSORIN standard. Shihni shkresën nr. *** prot., datë 16.11.2022, të ASHK Shkodër, në dosjen e Komisionit.

² Shihni *email*-in datë 24.2.2023, në dosjen e Komisionit.

shpenzime të energjisë elektrike, ndërkohë që subjekti në të gjitha DPV-të, në deklaratën *Vetting* dhe gjatë procesit ka deklaruar se ka banuar e vijon të banojë në të dyja apartamentet, të cilat janë bashkuar së bashku në apartamentin me sip. 151 m².

24. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i është kërkuar të japë sqarime në lidhje me konstatimet që duket se: (i) dy apartamentet nuk janë përdorur për banim sikurse subjekti ka deklaruar, pasi është vërtetuar që të jetë shpenzuar energji elektrike vetëm në periudha të shkurtra e të ndara kohore, ndërkohë që nga shtatori 2013 deri në korrik 2021, nuk ka fare shpenzime të energjisë elektrike për të dyja kontratat; (ii) është e paqartë përse lidhjet e kontratave të energjisë elektrike për pasuritë në pronësi të bashkëshortit të subjektit, përkatësisht, që në vitet 1997 dhe 1998 janë kryer në emër të shtetasit L. R., babai i tij.

25. Në parashtrimet e saj subjekti ka deklaruar se mosshpenzimi i energjisë elektrike ka ardhur për shkak se ajo dhe familja e saj kanë banuar në shtëpinë e prindërve të saj me adresë rruga “****”, Shkodër (trajtuar në vijim në paragrafet 71-74 të këtij vendimi), duke sqaruar se ajo ka qenë vajzë e vetme në familjen e origjinës. Vëllezërit e saj pas viteve ‘90 janë larguar nga Shqipëria dhe nëna e subjektit ka jetuar e vetme në shtëpinë e saj dhe, për këtë arsye, kanë menduar të jetojnë së bashku. Në këtë mënyrë, subjekti kujdesej për nënën, ndërkohë që fëmijët e saj vazhdonin shkollën, e cila ishte shumë afër me banesën e nënës. Pasi nëna e subjektit ndërroi jetë në vitin 2014, subjekti dhe bashkëshorti i saj vijuan të jetonin në banesën private të familjes së subjektit, pasi fëmijët J. dhe G. R. filluan gjimnazin dhe shkolla ishte shumë afër me këtë banesë. Sa i takon konstatimit se përse kontratat e energjisë elektrike për pasuritë në pronësi të bashkëshortit janë në emër të shtetasit L. R., subjekti i rivlerësimit nuk dha asnjë deklaram. Ndërsa gjatë procesit ka sqaruar se emri i babait të bashkëshortit ka mbetur si emër klienti, duke lënë të kuptohet në deklaramet e veta se këto dy kontrata i përkasin apartamentit objekt verifikimi dhe pasurisë tjetër të përfutur me dhurim nga bashkëshorti, të cilat janë bashkuar në një të vetëm.

26. Në procesin e vlerësimit përfundimtar konstatohet se për herë të parë në parashtrime, subjekti i rivlerësimit deklaroi dhe pranoi faktin që dy apartamentet me sipërfaqe totale 151 m² nuk i ka përdorur për banim, pasi ajo familjarisht ka banuar në shtëpinë e nënës së saj. Ky deklaram bie në kundërshtim me të gjitha deklaramet e mëparshme të subjektit pasi: (i) në DPV-të ndër vite ka deklaruar si adresë banimi lagjja “****”, p. nr. *** (adresa e apartamentit me sip. 151 m²) dhe nuk ka deklaruar vendqëndrim tjetër; (ii) në deklaratën *Vetting*, pasi ka deklaruar si adresë banimi adresën e ap. me sip. 151 m², lagjja “****”, p. nr. ***, në rubrikën nëse dispononi vendqëndrim tjetër ka deklaruar “*nuk disponoj*”, ndërsa në rubrikën përshkrimi i pasurive nuk ka deklaruar të ketë në posedim apo në përdorim banesën e nënës; (iii) në përgjigje të pyetësorit standard ka deklaruar se nga data 1.6.1999 vijon të jetojë në apartamentin nr. ***, lagjja “****” (ap. me sip. 151 m²) pa përmendur banesën e nënës së saj; (iv) në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar se *apartamenti me sip. 75 m² (objekt verifikimi) është përdorur nga prindërit e bashkëshortit deri sa kanë ndërruar jetë dhe nga motra e bashkëshortit vetëm në periudha tremujore kur ka qëndruar në Shqipëri, pasi ajo është shtetase australiane. Apartamenti me sipërfaqe prej 76 m² (përfutur nga bashkëshorti me dhurim, trajtuar në vijim) është përdorur vetëm nga subjekti me bashkëshortin dhe dy fëmijët. Pas ndërrimit të jetës së prindërve të bashkëshortit, përkatësisht nëna në vitin 1999 dhe babai në vitin 2009, të dyja apartamentet (me sip. 151 m²) janë përdorur vetëm nga familja e subjektit.*

27. Në këto kushte, Komisioni çmon se subjekti nuk ka zbatuar detyrimin ligjor për të deklaruar banesën e nënës së saj në DPV ndër vite si adresë banimi apo si vendqëndrim tjetër, sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, ndërkohë që edhe në deklaratën *Vetting* në kundërshtim me

përcaktimet e nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës³ dhe ligjit nr. 84/2016⁴ subjekti nuk ka deklaruar posedimin/përdorimin e banesës në pronësi të nënës së saj L. B. Nga ana tjetër, gjatë procesit të rivlerësimit subjekti ka vijuar me pohime të pavërteta duke deformuar realitetin, pasi ka deklaruar se ka banuar në apartamentin me sip. 151 m² në pronësi të bashkëshortit të saj me adresë lagjja “****”. Vetëm në parashtrimet e veta, pasi Komisioni evidentoi mospërdorimin e këtij apartamenti nëpërmjet të dhënave të FSHU-së, subjekti, i ndodhur përpara këtij fakti, ka deklaruar se kjo ka ndodhur pasi ajo dhe familja e saj kanë banuar me shtëpinë e nënës së saj. Ky qëndrim i subjektit vërteton se deklarimet e mëparshme të saj në lidhje me adresën e banimit kanë qenë të rreme. Ky fakt dhe mosdeklarimi në mënyrë të vijueshme i një pasurie në përdorim/adresës së banesës së nënës së saj, përveçse vijnë në kundërshtim me etikën e një magjistrati ka vështirësuar punën e Komisionit për evidentimin e investimeve të mundshme në banesën e nënës së subjektit ndër vite. Për pasojë, Komisioni vlerëson gjithë qëndrimin e subjektit si përpjekje për të fshehur përdorimin e banesës së nënës së saj e, për pasojë, në kuptim të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

Në lidhje me fitimin e pronësisë së apartamentit objekt verifikimi me sip. 76 m²

28. Nga aktet⁵ u verifikua se:

- Sipas akt shitblerjes nr. ***, datë 8.10.1993, N. B. Shkodër i shet shtetasve D. G., etj., apartamentin me sip. 76 m², ndodhur në k. ***, hyrja ***. Sipas planimetrisë, apartamenti ndodhet në lagjen “****”, rruga “****”, p. ***, h. ***, k. ***.
- Sipas akt dhurimit nr. ***, datë 15.12.1998, dhuruesit D. G. etj. i dhurojnë shtetasit K. R. apartamentin me sip. 76 m², ndodhur në adresën e sipërshënuar.
- Sipas kartelës së pasurisë dhe certifikatës së pronësisë datë 14.12.2010, pasuria nr. ***, apartamenti me sip. 76 m², Shkodër, figuron i regjistruar në pronësi të shtetasit K. R.
- Në DPFD 2003, subjekti e ka deklaruar apartamentin me sip. 76 m², me vlerë 1.8 milionë lekë. Kjo vlerë nuk përputhet me vlerën 500.000 lekë, deklaruar në deklaratën *Vetting*.
- Në DPV 2004, subjekti ka deklaruar: *Shtëpi banimi (apartament) me sip. 151 m², 1/2 e kësaj prone përfituar nga privatizimi i banesave shtetërore (falas) në favor të bashkëshortit me akt dhurimi nga prindërit e tij, vlera e pasurisë falas (ka përfshirë edhe sipërfaqen e ap. 75 m², përfituar nga bashkëshorti me dhurim, trajtuar në vijim).*

29. Duke qenë se ka pasur paqartësi në këto deklarime, subjekti është pyetur nga ILDKPKI-ja. Sipas procesverbaleve⁶ të datave 18.9.2014 dhe 3.10.2014, subjekti ka sqaruar se apartamentin me sip. 76 m², deklaruar në DPFD 2003 në fakt e ka blerë, pavarësisht se kontrata është bërë me akt dhurimi. E pyetur mbi banesën me sip. 151 m², të deklaruar në DPV 2004, subjekti ka sqaruar se në fakt janë dy apartamente, një me sip. 75 m² (trajtuar në vijim me origjinë nga privatizimi dhe dhuruar nga prindërit pjesa e tij takuese) dhe tjetri 76 m² që është edhe apartamenti objekt verifikimi.

30. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar apartament me sip. 76 m², nr. pasurie ***, fituar me akt dhurimi datë 15.12.1998, në fakt paguar vlera 500.000 lekë me të ardhura të

³ “Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim...”.

⁴ Neni 3, pika 11: “Pasuri janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, ‘Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë’, i ndryshuar që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit”.

⁵ Shihni dokumentet në aneksin 4/2 dhe 28 e ILDKPKI-së dhe deklarimet e subjektit.

⁶ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 4.6.2021 dhe nr. *** prot., datë 9.11.2022, të ILDKPKI-së, në dosjen e Komisionit.

përbashkëta. Në lidhje me shtetasit D. G., Sh. G., E. G., A. G. dhe E. G., pas verifikimeve të kryera⁷ nuk rezultuan të dhëna për konflikt interesi.

31. Sa më sipër, nuk konstatohen problematika në lidhje me origjinën e pronës, por ka mospërputhje sa i takon fitimit të pronësisë, pasi sipas akt dhurimit datë 15.12.1998, bashkëshorti i subjektit K. R. ka përfituar një shtëpi banimi apartament me sip. 76 m², ndërkohë që subjekti ka deklaruar se kjo pasuri është e blerë. Sa i takon çmimit të blerjes, në DPDFD 2003 ka deklaruar shumën 1.800.000 lekë, ndërsa në deklaratën *Vetting* ka deklaruar shumën 500.000 lekë. Me qëllim zbardhjen e rrethanave të mësipërme, në pyetësonin nr. 2, iu kërkua subjektit të japë sqarime, e cila në përgjigje të këtij pyetësoni⁸, deklaroi se:

- Hartimi i kontratës së dhurimit është bërë nga noteri, i cili e ka zgjedhur vetë këtë mënyrë. Marrëdhënia nuk ka qenë dhurim, por shitje, pasi në fakt shitësit i është dhënë shuma 1.800.000 lekë. Ndërsa në lidhje me sigurimin e kësaj shume shpjegon se ajo vetë, në datën 3.8.1996, ka blerë një apartament në shumën 1.300.000 lekë, me të ardhura nga puna e saj prej 11 vitesh para se të fillonte si nd/gjyqtar (datë 22.8.1996), kur priste fëmijën e parë. Më pas, në datën 7.6.1997, deklaroi se e ka shitur këtë apartament në shumën 1.350.000 lekë te shtetasi R. S. P., nga e cila 1.300.000 lekë i është dhënë shitësve (dhuruesve) G. në kohën kur është hartuar kontrata e dhurimit, ndërsa bashkëshorti i saj ka shtuar vlerën 500.000 lekë.

- Në këto kushte, duke qenë se shuma prej 1.300.000 lekësh ka qenë para se të martohej dhe të fillonte punën si gjyqtare, nuk e ka deklaruar asnjë herë, por ka deklaruar vetëm shumën 500.000 lekë. Kjo ka qenë arsyeja pse fillimisht ka deklaruar vlerën 1.800.000 lekë, ndërsa shuma 500.000 lekë është deklaruar nga ajo pasi në atë kohë kishte filluar punën si nd/gjyqtare.

- Subjekti deklaroi se nuk ka qenë në dijeni të aktit të dhurimit të bërë nga bashkëshorti, si dhe nuk ka pasur komunikim me shitësit, pasi kanë qenë në hyrje të ndryshme.

- Në përgjigje të pyetësonit nr. 2 subjekti paraqiti disa akte shkresore⁹ për të vërtetuar pretendimet e veta. Me njoftimin e rezultateve të hetimit iu kërkua subjektit të paraqesë dokumentet e mësipërme origjinale ose kopje të noterizuara, e cila në parashtrimet e saj paraqiti akte të dosjes së origjinës së pasurisë, përfshirë dy kontratat e shitjes.

32. Nga gjitha sa më sipër, në përfundim të hetimit rezultoi se: (i) pavarësisht se *de jure* pasuria është përfituar me kontratë dhurimi, nga deklaratimet konsistente të subjektit në DPV, ILDKPKI, deklaratën *Vetting* dhe gjatë procesit, rezultoi që *de facto* pasuria është përfituar me shitje në datën 15.12.1998 dhe jo me dhurim; (ii) pasuria është blerë me çmim 1.800.000 lekë dhe jo 500.000 lekë sa është deklaruar në deklaratën *Vetting*. Kjo shumë është konsideruar si shpenzim në vitin 1998, i cili i përket periudhës përpara detyrës.

Në lidhje me burimin e krijimit të vlerës 1.800.000 lekë nga aktet në dosje rezultoi¹⁰ se:

33. Në DPDFD 2003 ku subjekti ka deklaruar vlerën e apartamentit në shumën 1.800.000 lekë, ka deklaruar si burim kursimet nga puna. Sipas shpjegimeve në pyetësonin nr. 2, shuma prej 1.300.000 lekësh ka si burim shitjen e apartamentit në vitin 1997, ndërsa shuma prej 500.000 lekësh është dhënë nga bashkëshorti. Sa i takon shpenzimeve të mobilimit, subjekti sqaroi se fillimisht ka shpenzuar 107.000 lekë: në vitin 2000 ka shpenzuar 56.000 lekë; në vitin 2001 ka shpenzuar 70.000 lekë; në vitin 2002 ka shpenzuar 85.000 lekë; në vitin 2004 ka shpenzuar

⁷ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 9.9.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në dosjen e Komisionit. Sipas kësaj shkrese verifikimi është kryer për periudhën 1998 e në vijim dhe dokumentacioni i mëparshëm është dëmtuar nga djegia në vitet 1997 e 1998.

⁸ Shihni përgjigjet e pyetësonit nr. 2 dhe dokumentet bashkëlidhur, protokolluar me nr. *** prot., datë 21.11.2022.

⁹ Shihni: (i) fotokopje të kontratës së shitjes nr. ***, datë 3.8.1996, sipas së cilës, subjekti i ka blerë shtetasit D.P., një apartament me sip. 76 m², H. ***, K. ***, në vlerën 1.300.000 lekë; (ii) fotokopje të kontratës nr. ***, datë 7.6.1997, sipas së cilës, subjekti i ka shitur në shumën 1.350.000 lekë, shtetasit R. P., një apartament me sip. 76 m², në adresën lagjen "****", rruga "****", p. nr. ***, H. ***, K. ***; (iii) fotokopje të shkresës së ASHK-Shkodër datë 1.6.2021, sipas së cilës pasuria me nr. *** ka kaluar në pronësi të shtetasit R. S. P. dhe aktualisht është në pronësi të trashëgimtarëve të z. R. P.

¹⁰ Shihni aneks 4/88, 4/9 në dosjen e ILDKPKI-së dhe dokumentet në pyetësonin standard.

19.000 lekë. Këto shuma janë përfshirë si shpenzime të kryera gjatë këtyre viteve. Në përfundim të hetimit administrativ, në analizën financiare u pasqyrua si shpenzim shuma 1.800.000 lekë – evidentuar si çmimi i paguar *de facto* për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi në datën 15.12.1998, si dhe shpenzimet e mobilimit sipas deklarimeve të subjektit.

34. Komisioni ka kryer verifikimin e të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur deri në momentin e pagimit të shumës 1.800.000 lekë, si vijon:

34.1. Janë analizuar të ardhurat e subjektit të rivlerësimit si ndihmës gjyqtare nga pagat, pasqyruar në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ.

34.2 Janë analizuar të ardhurat nga pagat e bashkëshortit të subjektit si hetues, avokat, gjyqtar, pedagog i jashtëm në Universitetin e Shkodrës, të ardhurat nga paga si i vetëpunësuar pranë personit fizik, noter K. R., pasqyruar në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ.

34.3. Të ardhurat e dokumentuara për të cilat janë paguar detyrimet tatimore janë përfshirë në analizën financiare të kryer në përfundim të hetimit administrativ.

34.4. Janë analizuar të ardhurat e pretenduara nga shitja e një apartamenti në Shkodër në vitin 1997, deklaruar për herë të parë si burim gjatë procesit të rivlerësimit, si vijon:

34.4.1. Me kontratë të datës 3.8.1996 subjekti ka blerë një apartament në Shkodër nga shtetasi D. P., në çmimin 1.300.000 lekë. Me kontratën datë 7.6.1997 subjekti i ka shitur shtetasit R. P. këtë pasuri në vlerën 1.350.000 lekë. Edhe pse ky burim është deklaruar për herë të parë gjatë procesit, Komisioni kreu hetime në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave për blerjen e pasurisë në çmimin 1.300.000 lekë në datën 3.8.1996 dhe nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie. Po kështu, të ardhurat nga shitja e kësaj pasurie nuk janë deklaruar si burim krijimi të pasurisë objekt verifikimi as në DPDFD 2003, as kur është pyetur nga ILDKPKI-ja në vitin 2014 mbi burimin e pasurisë objekt vlerësimi, si dhe as në deklaratën *Vetting*. Për më tepër, subjekti ka deklaruar në DPDFD 2003 një depozitë bankare në shumën 2.360.000 lekë, me burim nga kursimet e vazhdisë dhe kursimet e bashkëshortit dhe nuk është e qartë nëse të ardhurat nga shitja e apartamentit në shumën 1.350.000 lekë në datën 7.6.1997 kanë shërbyer si burim krijimi për këtë depozitë apo si burim për blerjen e pasurisë objekt verifikimi.

34.5. Bazuar në sa më sipër, në përfundim të hetimit administrativ, të ardhurat nga shitja e pasurisë në vlerën 1.350.000 lekë, përfituar nga shitja e apartamentit në datën 7.6.1997 nuk janë konsideruar si burim i ligjshëm për blerjen e pasurisë objekt verifikimi. Ndërkohë, me njoftimin e rezultateve të hetimit, iu kërkua subjektit të japë sqarime e dokumente shkresore në lidhje me krijimin e depozitës bankare të deklaruar në DPDFD 2003, vitin/periudhën/historikun dhe burimin e krijimit të saj. Në parashtrimet e saj subjekti i rivlerësimit nuk dha asnjë sqarim në lidhje me këtë depozitë.

Në lidhje me analizën financiare

35. Bazuar në deklaratimet e subjektit, si edhe në dokumentacionin e administruar, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për periudhën 1.1.1996 – 15.12.1998, me qëllim evidentimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për kryerjen e pagesës në shumën 1.800.000 lekë për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi në datën 15.12.1998, të llojit “apartament” me sip. 76 m², në Shkodër, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 1

	Periudha 1996 - 15.12.1998
--	---------------------------------------

A) PASURI	3,100,000
Apartament me sip. 76 m ² , H. ***, K. ***, ndodhur në rrugën “****”, Shkodër, në vlerën 1.300.000 lekë, në datën 3.8.1996 nga shtetasi D. P.	1,300,000
Shtëpi banimi, apartament, me sip. 76 m ² , nr. pasurie ***, z. k. ***, adresa lagjja “****”, rruga “****”, p. nr. ***, Shkodër. Paguar vlera 1.800.000 lekë në datën 15.12.1998.	1,800,000
Ndryshim likuiditeti	0
B) DETYRIME	0
C) PASURI NETO (A-B)	3,100,000
D) TË ARDHURA	1,130,778
Të ardhura nga paga e SR	553,000
Të ardhura nga paga e bashkëshortit të SR	69,218
Të ardhura nga ushtrimi i aktivitetit të bashkëshortit të SR	508,560
Të ardhura nga shitja e apartamentit me sip. 76 m ² , H. ***, K. ***, ndodhur në rrugën “****”, Shkodër, në vlerën 1.350.000 lekë, në datën 7.6.1997 shtetasit R. P.	0
E) SHPENZIME	410,664
Shpenzime minimale jetike	410,664
Balanca e fondeve (D-C-E)	-2,379,886

36. Në përfundim të hetimit administrativ, subjektit i kaloi barra e provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të dhënë argumentet dhe provat në lidhje me konstatimet, duket se: (i) subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën në vlerën 1.800.000 lekë në datën 15.12.1998 për blerjen e apartamentit objekt vlerësimi, për shkak të një balance negative në vlerën – 2.379.886 lekë; (ii) ka mospërputhje të faktit sa i takon përfitimit të pasurisë, pasi kontrata e fitimit të pasurisë është kontratë dhurimi, ndërkohë që subjekti deklaroi që e ka përfituar me shitje; (iii) ka mospërputhje në deklarimin e çmimit të shitjes, pasi në deklaratën *Vetting* ka deklaruar çmimin 500.000 lekë, ndërsa që në DPV-në e vitit 2003, në ILDKPKI dhe gjatë procesit, ka deklaruar si çmim shumë më 1.800.000 lekë; (iv) për herë të parë gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti ka deklaruar si burim shumë më 1.300.000 lekë, përfituar nga shitja e apartamentit në datën 7.6.1997 në çmimin 1.350.000 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

37. Në parashtrimet e saj, subjekti pretendon se analiza e kryer nga Komisioni prezantohet sikur ajo me bashkëshortin kanë investuar për dy pasuri të paluajtshme të llojit “apartament” në harkun kohor 1996 – 1998, por faktikisht apartamenti i blerë në vitin 1996 është shitur në vitin 1997 dhe është blerë një i ngjashëm në vitin 1998. Sipas saj, në analizën financiare duhet të përfshihen të ardhurat nga shitja e apartamentit në vlerën 1.350.000 lekë, i blerë në vitin 1996 para martesë me të ardhura plotësisht të ligjshme.

38. Në lidhje me të ardhurat e ligjshme që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit në vitin 1996, subjekti pretendon se familja e saj është kompensuar në datën 7.12.1994 me një vlerë prej 864.897 lekësh dhe në datën 26.7.1996 me një vlerë prej 718.560 lekësh, për burgimin dhe vdekjen e padrejtë të babait dhe vëllait të saj. Për tërheqjen dhe administrimin e këtyre

shumave, ajo së bashku me vëllezërit kanë autorizuar nënën e tyre të veprojë pranë arkës së kursimit Shkodër me prokurë të posaçme. Sipas subjektit, referuar edhe akteve të gjendjes civile të trungut familjar për vitet 1994 – 1996, ajo jetonte së bashku me nënën dhe një vëlla, në një kohë që vëllezërit e tjerë ishin të gjithë emigrantë dhe se me dakordësi familjare, një pjesë e këtij kompensimi prej 1.000.000 lekësh është përdorur për blerjen e apartamentit në gusht të vitit 1996. Për këtë veprim, subjekti sqaron se nuk ka mbajtur ndonjë dokument, pasi sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë për marrëdhëniet juridike ndërmjet të afërmeve, dhe sidomos ndërmjet nënës, vëllezërve dhe motrës, nuk kërkohet forma shkresore, që sipas subjektit, një qëndrim i tillë është mbajtur dhe pranuar nga Komisioni me vendimin nr. ***, datë 31.7.2018. Në këto rrethana subjekti pretendon se për periudhën 1995 – 5.12.1998 balanca e fondeve rezulton me tepriçë kreditore në vlerën 645.519 lekë.

39. Sa i përket faktit se përfitimi i pasurisë sipas kontratës datë 15.12.1998 është bërë me dhurim, ndërkohë që e deklaron të përfituar me shitje, subjekti pretendon se hetimi me datë duhet të orientohet drejt mënyrës së fitimit të pronësisë së kësaj pasurie, që sipas saj, veprimet konkrete dhe të provuara kanë sjellë pasojat juridike të fitimit të titullit të pronësisë dhe regjistrimit në hipotekë. Sipas subjektit, në asnjë moment nuk ka fshehur ose tjetërsuar të vërtetën, pasi kjo pasuri është përfituar kundrejt çmimit 1.800.000 lekë të paguar dhe të deklaruar në DPFD 2003. Ndërsa deklarimi në deklaratën *Vetting* të çmimit prej 500.000 lekësh, sipas saj, është një pasaktësi e paqëllimshme, nisur nga rrethanat e prezantuara dhe dinamika e deklarimeve.

40. Sa i përket mospërputhjes së çmimit të shitjes të deklaruar në deklaratën *Vetting* prej 500.000 lekësh, me atë të deklaruar në vitin 2003, në ILDKPKI dhe gjatë procesit, në shumën prej 1.800.000 lekësh, subjekti pretendon se është një pasaktësi jo e qëllimshme për mënyrën se si e ka perceptuar deklarin, duke e lidhur këtë deklarin si një detyrim nga momenti kur është emëruar në detyrën e ndihmës gjyqtares në datën 22.8.1996.

41. Ndërsa për faktin se për herë të parë gjatë procesit ka deklaruar si burim shumën 1.300.000 lekë, përfituar nga shitja e apartamentit në datën 7.6.1997, subjekti i rivlerësimit nuk dha sqarime.

42. Sa i takon të ardhurave të bashkëshortit nga pagat, subjekti pretendon se Komisioni në analizën financiare nuk ka marrë parasysh dhe nuk ka realizuar hetim të thelluar, pasi sipas saj totali ., referuar ligjit nr. 7668, datë 2.2.1993, “Për pagat e gjyqtarëve, prokurorëve dhe hetuesve” dhe VKM-ve përkatëse, rezulton në shumën 604.014 lekë, të cilat duhet të shtohen në analizën financiare. Sipas subjektit, sigurimi i dokumentacionit të kohës është shumë i vështirë të sigurohet për shkak të viteve që kanë kaluar, si dhe faktit që një pjesë e gjykatave janë suprimuar e një pjesë janë djegur dhe me cilësinë e provës paraqet shkresën nr. *** prot., datë 1.11.1995, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kuçovë, ku citohet për t’u përdorur si analogji për përllogaritjen e të ardhurave. Sa i takon të ardhurave nga pagat për periudhën 1.12.1986 – 1.6.1989 si hetues, pretendon një shumë prej 21.000 lekësh, por sipas subjektit nuk kanë ndikim në analizën financiare dhe, për këtë arsye, e lë në çmim të Komisionit nëse do t’i përfshijë ose jo. Subjekti sqaron se dokumentacioni i kohës mungon dhe se ajo është në kushtet e pamundësisë objektive për të llogaritur këto të ardhura dhe për këtë arsye kërkon që të mbahet parasysh neni 32/2 i ligjit nr. 84/2016. Në mbështetje të pretendimeve të saj, subjekti paraqiti disa dokumente¹¹ shkresore.

¹¹ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 30.3.2023, të Ministrisë së Drejtësisë sipas së cilës: K. R. është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Shkodër me datë 7.12.1991. Me vendimin nr. ***, datë 23.2.1993, të KLD-së K.R. është emëruar Kryetar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Malësisë së Madhe. Me vendimin nr. ***, datë 23.8.1996, të KLD-së K. R. lirohet nga detyra. Në lidhje me punësimin si hetues pranë hetuesisë së rrethit Elbasan për periudhën 1.12.1986 -1.6.1989 nuk ka të dhëna të regjistruara. Ministria e Drejtësisë ka kryer dorëzimin e fondit arkivor me ruajtje të përhershme të viteve 1990 – 1995, pranë DPA-së. Për vitin 1996 dokumentacioni është në fazën e inventarizimit; kopje të shkresave të Ministrisë së Drejtësisë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kuçovë në lidhje me pagat e gjyqtarëve etj.

Për të mbështetur pretendimet e saj, subjekti paraqiti disa dokumente shkresore¹².

Vlerësimi i Komisionit

43. Në procesin e vendimmarrjes, Komisioni vlerëson se në parashtrimet e saj subjekti ka shtuar një burim të krijimit për apartamentin e blerë në vitin 1996, krahasimisht me deklaratimet në përgjigje të pyetësorit nr. 2 dhe shpjegimet në ILDKPKI kur është pyetur për pasurinë e blerë në vitin 1996, ku ka deklaruar si burim krijimi kursimet nga puna e saj nga viti 1980 deri në vitin 1991. Veç kësaj, në lidhje me të ardhurat e pretenduara nga kompensimi, subjekti arriti të provojë me dokumentacion vetëm gjendjen e tyre në arkën e kursimeve në vitet 1994 dhe 1996, por nuk arriti të provojë nëse/kur janë tërhequr dhe nga kush e, për rrjedhojë, pretendimi i saj se nga këto të ardhura ka përfituar shumën prej 1.000.000 lekësh, të cilat kanë shërbyer për blerjen e apartamentit në vitin 1996, mbeten vetëm në nivel deklarativ. Sa i takon vendimit nr. ***, datë 31.7.2018, të Komisionit, të cilit subjekti i referohet për analogji, Komisioni vlerëson se nuk mund të merret në konsideratë, për sa kohë që, në rastin në fjalë rrethanat dhe faktet janë të ndryshme, por, dhe për faktin se subjekti nuk paraqiti ndonjë dokument për të vërtetuar dhurimin nga familjarët e saj të shumës së pretenduar prej 1.000.000 lekësh.

44. Pretendimi i subjektit se Komisioni nuk ka kryer një hetim të thelluar në lidhje me pagat e bashkëshortit është një pretendim i pabazuar në fakte dhe ligj, pasi në deklaratën *Vetting*, si dhe gjatë procesit të hetimit administrativ nuk paraqiti ndonjë provë që të vërtetonte minimalisht marrëdhënien e punës së bashkëshortit. Në këtë çështje, subjekti tregon perceptim të gabuar të pozitës së tij dhe të Komisionit në procesin e rivlerësimit të pasurisë, pasi Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 nuk i njeh si detyrim Komisionit të provojë të ardhurat e ligjshme të subjektit, por është ky i fundit që mbart një detyrim të tillë, ndërsa Komisioni si një organ rivlerësimi ka detyrë t'i hetojë dhe vlerësojë ato sipas rregullave të përcaktuara në ligj. Sa i takon të ardhurave të bashkëshortit, subjekti, në prapësimet e veta, arriti të vërtetojë marrëdhënien e punës së bashkëshortit për periudhën 7.12.1991 – 23.8.1996 si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe kryetar gjykate në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Malësisë së Madhe dhe të ardhurat nga paga e personit të lidhur gjatë kësaj periudhe janë përfshirë në analizën financiare të rishikuar në shumën 604.000 lekë. Nga ana tjetër, u reflektuan shpenzimet minimale jetike të përbëllura për këtë periudhë, të cilat logjikisht sipas realitetit social – ekonomik të kohës janë vlerësuar minimalisht sa 66% e të ardhurave dhe, për rrjedhojë, impakti financiar për pjesën e cila potencialisht mund të ishte kursyer nga personi i lidhur në vlerën 205.000 lekë¹³ nuk e përmbys barrën e provës për balancën negative të fondeve, paraqitur në rezultatet e hetimit në vlerën – 2.379.887 lekë, për periudhën deri në datën e investimit të pasurisë objekt vlerësimi deri më 15.12.1998.

45. Sa i përket mospërputhjeve në lidhje me mënyrën e fitimit të pronësisë dhe çmimit të deklaruar të shitjes së pasurisë objekt verifikimi, në përfundim Komisioni çmon se mospërputhjet nuk kanë sjellë ndonjë pasojë për sa kohë subjekti ka deklaruar në DPF 2003 çmimin 1.800.000 lekë, duke pranuar në këtë mënyrë që pasuria është përfituar me shitje dhe jo me dhurim. Por, pavarësisht këtij fakti dhe argumenteve të subjektit, e cila përpiqet të japë një trajtim juridik fitimit të titullit të pronësisë, në kushtet e përsëritjes së mospërputhjeve në

¹² Shihni: (i) prokurë të posaçme nr. ***, datë 25.11.1994, sipas së cilës Gj., A., V., E. dhe Izabela B., autorizojnë nënën e tyre L. B. për tërheqjen dhe administrimin e të hollave, të cilat rrjedhin trashëgim nga i ndjeri Ç., si dhe të tërheqë dhe administrojë edhe letrat me vlerë si dhe M. (duket korrigjim nga noteri); (ii) certifikatë vdekjeje të Ç. B., vdekur më 13.2.1988, si dhe certifikatë familjare datë 29.3.2023, sipas së cilës përbërja familjare për periudhën 3.10.1990 – 23.10.1996 përbëhet nga nëna e subjektit, vëllai i subjektit dhe subjekti; (iii) vërtetim i njësisë me origjinalin të librezës së degës së kursimeve me nr. llogarie *** datë 7.12.1994 me përfitues Ç. dhe L. B. dhe të librezës së degës së kursimeve me nr. llogarie ***, datë 26.7.1996 me përfitues M. dhe L. B. Në këto librezë pasqyrohet vetëm derdhja e këtyre shumave në këto data, por nuk pasqyrohet tërheqja e tyre; (iv) vërtetim nga ISSH DRSH nr. *** prot., datë 29.3.2023 sipas së cilës familja Ç.B. me anëtare në ngarkim Izabela Ç. B., është trajtuar me pension nga data 1.9.1992 deri më 30.8.1996 në shumën 71391 lekë; (vi) dokumentet e origjinës së pronës të administruar edhe më parë nga Komisioni.

¹³ Shuma e pagave në vitet 1991 – 1996 prej 604.000 lekësh – 66% si shpenzime minimale jetike rezulton në shumën 205.000 lekë.

deklarime dhe qëndrimeve jokoherente edhe për pasuri të tjera, në përfundim të procesit, për Komisionin mbetet e paqartë përse subjekti nuk ka kryer deklarime të sakta në deklaratën *Vetting* në lidhje me mënyrën e fitimit të pronësisë dhe çmimin e blerjes së pasurisë kur ligji ia kishte dhënë të gjithë mundësinë.

46. Sa i takon të ardhurave nga shitja e pasurisë apartament më 7.6.1997, subjekti nuk dha asnjë sqarim në lidhje me faktin se për herë të parë gjatë procesit ka deklaruar si burim të pasurisë objekt verifikimi shumë e përfituar nga shitja prej 1.350.000 lekësh. Po kështu, duke treguar një qëndrim jobashkëpunues me Komisionin, nuk dha asnjë sqarim e dokument shkresor në lidhje me krijimin e depozitës bankare të deklaruar në vitin 2003, duke e lënë të paqartë nëse të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë në vitin 1997 kanë shërbyer si burim i depozitës apo si burim për blerjen e pasurisë objekt verifikimi. Në përfundim, vlerësohet se subjekti nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e të ardhurave për blerjen e apartamentit në datën 3.8.1996 dhe as faktin që shuma prej 1.300.000 lekësh, e përfituar nga shitja e apartamentit në datën 7.6.1997, ka shërbyer si burim krijimi për apartamentin objekt verifikimi. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë vërtetuar të kundërtën e barrës së provës në lidhje me mungesën e të ardhurave të ligjshme për të justifikuar pagesën në vlerën 1.800.000 lekë, në datën 15.12.1998, për blerjen e apartamentit objekt vlerësimi, sipas parashikimit të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Në analizën financiare të rishikuar pasi janë marrë në konsideratë disa nga pretendimet e subjektit, balanca negative u zvogëluar në shumën – 2.174.521 lekë, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë.

Tabela nr. 2

	Periudha 1991 - 15.12.1998
A) PASURI	3,100,000
Apartament me sip. 76 m ² , H. ***, K. ***, ndodhur në rrugën “****”, Shkodër, në vlerën 1.300.000 lekë, në datën 3.8.1996 nga shtetasi D. P.	1,300,000
Shtëpi banimi, apartament, me sip. 76 m ² , nr. pasurie ***, z.k. ***, adresa lagjja “****”, rruga “****”, p. nr. ***, Shkodër. Pagar vlera 1,800.000 lekë në datën 15.12.1998.	1,800,000
Ndryshim likuiditeti	0
B) DETYRIME	0
C) PASURI NETO (A-B)	3,100,000
D) TË ARDHURA	1,734,792
Të ardhura nga paga e SR	553,000
Të ardhura nga paga e bashkëshortit të SR	69,218
Të ardhura nga ushtrimi i aktivitetit të bashkëshortit të SR	508,560
Të ardhura nga paga e bashkëshortit 27.12.1991 – 23.8.1996	604,014
E) SHPENZIME	809,313
Shpenzime minimale jetike	809,313
Balanca e fondeve (D-C-E)	-2,174,521

47. Autoveturë tip “Daimler Chrysler”, me targa ***, me leje qarkullimi nr. ***, e regjistruar në DPSHTRR Shkodër, në emër të bashkëshortit, blerë që më 28.10.2008, me të ardhurat nga puna, bashkëngjitur dokumentacioni përkatës. Vlera: 1.000 euro. Pjesa takuese: 50 %. ILDKPKI-ja ka konstatuar se në DPV-në e vitit 2008 subjekti ka deklaruar blerje automjeti me kontratë të kryer nga Italia, si dhe shpenzime doganore në shumën totale 3.500 euro.

48. Nga aktet në dosje¹⁴ rezulton se:

- Sipas deklaratës së shitjes të shtetasit P. L.¹⁵ (Itali), mjeti i është shitur shtetasit K. R. me çmim 1.000 euro më 17.10.2008. Sipas deklaratës doganore datë 29.10.2008, detyrimet doganore janë në shumën 302.591 lekë. Mjeti me targë *** është regjistruar në emër të shtetasit K. R. sipas lejes së qarkullimit datë 30.10.2008 dhe certifikatës së pronësisë datë 4.4.2011.

- Në DPV-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar blerjen e mjetit në Itali në vlerën 2.500 euro, në emër të bashkëshortit, si dhe shpenzime të tjera doganore në shumën 1.000 euro. Siç vërehet ka një gabim në vlerën e blerjes dhe zhdoganimit, po në total është deklaruar saktësisht shpenzimi i kryer për blerjen dhe zhdoganimin.

- Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar vlerën 1.000 euro dhe jo 3.500 euro (çmimi i blerjes plus shpenzimet doganore). Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti nuk dha sqarime mbi arsyen e mosdeklarimit të vlerës së saktë në deklaratën *Vetting* të mjetit, por deklaroi se në fakt është ngatërruar vlera e doganës, e cila ka qenë 302.591 lekë, që me kursin e asaj kohe ka qenë në 2.500 euro, ndërsa blerja është deklaruar 1.000 euro (duket se i referohet DPV-së për vitin 2008). Në lidhje me shtetasin P. L., pas verifikimeve të kryera, nuk rezultuan të dhëna për konflikt interesi.

49. Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë, rezulton se:

49.1. Në DPV-në e vitit 2008 subjekti ka deklaruar pakësim të kursimeve të gjendjes në shtëpi, së bashku me bashkëshortin, përdorur për blerje mjeti, vlera 1.000.000 lekë. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si burim të ardhurat nga puna. Me qëllim kryerjen e analizës financiare, Komisioni konsideroi shumën 1.000 euro të paguar në datën 17.10.2008 sipas deklaratës së shitjes dhe shumën prej 302.591 lekësh të paguar në datën 29.10.2008 sipas deklaratës doganore. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2008 – 29.10.2008, me qëllim evidentimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për kryerjen e pagesës në shumën 1.000 euro dhe 302.591 lekë për blerjen dhe zhdoganimin e pasurisë objekt vlerësimi, pasqyruar në tabelën nr. 3 si më poshtë:

Tabela nr. 3

	Datë 29.10.2008
A) PASURI	2,954,819
Autovetura tip “Daimler Chrysler”, me targa ***, blerë që më 28.10.2008.	425,774
Njësi dyqan me sip. 34,5 m ² , e ndodhur në Shkodër, z. k. ***, realizuar aktmarrëveshje datë 19.2.2008.	3,000,000
Ndryshim likuiditeti	-470,955

¹⁴ Shihni aneks 4/3 dhe aneks 30, në dosjen ILDKPKI, shkresë nr. *** prot., datë 3.6.2021 dhe shkresë nr. *** prot., datë 23.8.2022, të DPSHTRR-së në dosjen e Komisionit.

¹⁵ Shihni kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 9.9.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në dosjen e Komisionit. Sipas kësaj shkrese verifikimi është kryer për periudhën 1998 e në vijim, pasi dokumentacioni i mëparshëm është dëmtuar nga djegia në vitet 1997 e 1998.

B) DETYRIME	0
C) PASURI NETO (A-B)	2,954,819
D) TË ARDHURA	1,713,383
Të ardhura nga paga e SR	688,062
Të ardhura nga paga e bashkëshortit të SR	120,200
Të ardhura nga ushtrimi i aktivitetit të bashkëshortit të SR	905,121
E) SHPENZIME	498,289
Shpenzime minimale jetike	455,400
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit	42,889
Balanca e fondeve (D-C-E)	-1,739,725

50. Në përfundim të hetimit administrativ bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të dhënë argumente dhe prova në lidhje me konstatimin, duket se, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën e çmimit të automjetit dhe shpenzimet e zhdoganimit duke rezultuar me balancë negative fondesh në shumën -1.739.725 lekë. Në parashtrimet e paraqitura subjekti nuk u dha ndonjë sqarim konkret në lidhje me këtë konstatim, por, është kundërshtuar në përgjithësi analiza financiare duke pretenduar ndër të tjera që të ardhurat e realizuara nga bashkëshorti për periudhën 1.1.2008 – 29.10.2008 të ripërlllogariten nga ana e Komisionit sipas qarkullimit dhe fitimit të mundshëm të realizuar sipas regjistrave¹⁶ fizikë të akteve dhe veprimeve të aktivitetit noterial të personit të lidhur K. R. dhe jo duke u bazuar në deklaratimet e kryera prej tij si person fizik në organet tatimore përkatëse për të njëjtën periudhë kohore. Nga ana tjetër, subjekti ka pretenduar se balanca negative e fondeve për blerjen e kësaj pasurie është e lidhur me mënyrën e pasqyrimit të shlyerjes së çmimit për pasurinë tjetër të blerë brenda të njëjtit vit kalendarik, e konkretisht për njësinë tregtare me sip. 34.5 m², të ndodhur në Shkodër, duke kundërshtuar pagesën e kryer prej 3.000.000 lekësh të përlllogaritur nga Komisioni në këtë vit, përkundrajt vlerës së pretenduar prej 1.000.000 lekësh. Përfundimisht, Komisioni konkludoi se në të ardhurat e krijuara nga personi i lidhur do të reflektohen vetëm ato të cilat janë konfirmuar nga organet tatimore sipas vetëdeklarimit të personit të lidhur në cilësinë e personit fizik, dhe se, në analizën financiare shlyerja e çmimit për blerjen e pasurisë së llojit njësi tregtare me sip. 34.5 m² do të reflektohet në vlerën 3.000.000 lekë më 19.2.2008, siç është trajtuar gjerësisht në paragrafët në vijim 51-60 të këtij vendimi. Në përfundim të procesit, subjekti nuk ka vërtetuar të kundërtën e barrës së provës në lidhje me mundësinë financiare për blerjen e mjetit objekt vlerësimi.

51. *Njësi dyqan me sip. 34,5 m², e ndodhur në Shkodër, z. k. ***, realizuar aktmarrëveshje datë 19.2.2008, sipas së cilës është paguar vlera prej 3.000.000 lekësh për periudhën 2007 – 2008 – 2009, meqenëse shitësi ka vdekur trashëgimtarja e tij nuk realizoi kontratën, pasi në mënyrë të padrejtë rriti vlerën e çmimit. Paguar në vitin 2014 edhe 500.000 lekë, mbetur pa u paguar edhe 500.000 lekë. Burimi i fitimit me të ardhura nga puna e të dyve. Vlera: paguar vlera prej 3.500.000 lekësh (3 milionë e pesëqind mijë) lekë. Pjesa takuese: 50%.*

51.1. Në lidhje me këtë pasuri ILDKPKI-ja ka konstatuar: Mosdeklarim i njësisë me sip. 34.5 m² në Shkodër, në DPV-të ndër vite. Është i paqartë burimi financiar i përdorur për shlyerjen e shumës 3.000.000 lekë, si dhe periudha e kryerjes së pagesave lidhur me blerjen e njësisë me sip. 34.5 m², në Shkodër, referuar aktmarrëveshjes datë 19.2.2008, si dhe deklaratës noteriale nr. ***, datë 2.10.2014. Mosdeklarim i detyrimit të mbetur për likuidimin e njësisë në shumën 500.000 lekë, në DPV-të ndër vite, si dhe në rubrikën përkatëse në deklaratën *Vetting*. Është e paqartë vlera e objektit njësi me sip. 34.5 m², në Shkodër, deklaruar e paguar në vlerën

¹⁶ Shihni prapësimet e dërguara nga subjekti pas njohjes me rezultatet e hetimit.

3.500.000 lekë dhe detyrimi i palikuiduar në vlerën 500.000 lekë, pasi në deklaratën noteriale citohet se shuma 3.000.000 lekë është paguar sipas aktmarrëveshjes datë 19.12.2008, por nuk përcaktohet nëse ka ende detyrime të tjera për të paguar edhe afatet e shlyerjes së tyre.

52. Bazuar në aktet në dosje¹⁷, aktet shkresore të vëna në dispozicion nga organet ligjore, deklaratimet periodike të subjektit, procesverbalet e datave 18.9.2014 dhe 3.10.2014 pranë ILDKPKI-së, si dhe deklaratimet e subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioni kreu disa verifikime në lidhje me këtë pasuri, pasqyruar në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ në përfundim të të cilit, në mënyrë të përmbledhur rezultoi se:

- Ka një marrëveshje të datës 19.2.2008, sipas së cilës rezultoi se shtetasi A. M. i shet shtetasit K. R. një dyqan me sip. 34.5 m², në një vlerë totale prej 3.000.000 lekësh, shumë e cila është likuiduar totalisht. Kjo marrëveshje konfirmohet edhe me deklaratën noteriale nr. ***, datë 2.10.2014, të shtetasit P. M. (e veja e shtetasit A. M.), e cila deklaroi se sipas deklaratimeve të bashkëshortit, është likuiduar plotësisht shuma 3.000.000 lekë, me këste gjatë viteve 2007 – 2008 - 2009.

- Pasuria figuron e regjistruar në emër të trashëgimtarëve të shtetasit A. M.

- Në datën 27.3.2015 është lidhur kontratë e energjisë elektrike në emër të shtetasit K. R., ndërkohë që lidhja e energjisë elektrike ishte bërë që në vitin 2008.

- Subjekti nuk ka kryer deklaratime të kësaj pasurie në asnjë prej deklaratimeve periodike vjetore. Gjatë procesit, subjekti ka deklaruar se në lidhje me blerjen e kësaj pasurie ka marrë dëgjimin në vitin 2010, deklarim i cili bie në kundërshtim me deklaratimin pranë ILDKPKI-së, ku ka deklaruar se në vitet 2007 dhe 2008 ka përdorur pakësimin e gjendjes *cash* për blerjen e pasurisë.

- Në deklaratën *Vetting* dhe deklaratimin në pyetësorin standard subjekti deklaroi kryerjen e një pagese tjetër prej 500.000 lekësh për blerjen e kësaj pasurie në datën 2.10.2014, pagesë e cila nuk rezultoi të jetë deklaruar nga shtetasja P. M. në deklaratën noteriale të datës 2.10.2014.

53. Sa i takon burimit të të ardhurave për pagimin e shumës 3.000.000 lekë, për njësinë me sip. 34.5 m², para se të kryhej analiza financiare, është bërë i domosdoshëm përcaktimi i kohës së pagesës së kësaj shume. Në lidhje me këtë fakt, nga aktet në dosje rezultoi se:

- Sipas aktmarrëveshjes datë 19.2.2008, shuma 3.000.000 lekë është likuiduar totalisht.

- Sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 2.10.2014, shtetasja P. M. ka deklaruar se, sipas thënies së bashkëshortit (të ndjerë), shuma prej 3.000.000 lekësh është likuiduar plotësisht me këste gjatë viteve 2007 – 2008 – 2009.

- Sipas procesverbalit datë 3.10.2014, në ILDKPKI, subjekti ka sqaruar se pagesat për shumën 3.000.000 lekë janë kryer në vitet 2007, 2008, 2009 dhe që nga viti 2010 nuk kanë kryer pagesa të tjera. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se bashkëshortja e të ndjerit, duke rritur sipërfaqen e njësisë pa të drejtë, kërkon edhe 1.000.000 lekë të tjera pavarësisht se në aktmarrëveshjen fillestare ka qenë 3.000.000 lekë.

- Në deklaratën *Vetting*, subjekti, përveç faktit të kryerjes së pagesës prej 3.000.000 lekësh në vitet 2007 – 2008 - 2009, ka deklaruar edhe kryerjen e pagesës në shumën 500.000 lekë në vitin 2014, ndërsa shuma 500.000 lekë ka deklaruar se nuk është paguar ende, si dhe ka paraqitur: (i) mandat tërheqje bankare datë 2.10.2014 të “Tirana Bank” për shumën 500.000 lekë, me përshkrimin *Izabela Radovani, pagë Shkodër*; (ii) mandatarkëtimin nr. ***, datë 2.10.2014, K. R., shuma 500.000 lekë, për 500.000:140 = 3.571 euro. Ky mandat nuk ka të dhëna sa kujt i është paguar shuma 500.000 lekë dhe as qëllimi.

- Në deklaratën për vitin 2014 nuk ka deklaruar kryerjen e pagesës 500.000 lekë dhe as detyrimin financiar në vlerën 500.000 lekë.

¹⁷ Shihni aneksin 4/4, në dosjen e ILDKPKI-së.

- Në pyetëtorin standard subjekti ka deklaruar se bashkëshortja e pronarit të ndjerë ka shtuar vlerën dhe sipërfaqen që i përket bashkëpronësisë, konkretisht korridorin, për të cilin në datën 2.10.2014 ka likuiduar shumën 500.000 lekë, të cilën sipas saj, e ka deklaruar edhe në deklaratën periodike. Nga verifikimi i DPV-së së vitit 2014, rezulton se subjekti ka deklaruar pakësim në depozitën “Tirana Bank” në llogari rrjedhëse në shumën 500.000 lekë, por pa deklaruar pagesë në vlerën 500.000 lekë për blerjen e njësisë objekt verifikimi. Edhe në rubrikën “përshkrimi i shpenzimeve”, ku kërkohet të deklarohen shpenzime mbi vlerën 300.000 lekë, nuk e ka deklaruar si shpenzim shumën 500.000 lekë. Ndërkohë, nuk ka kryer deklarime në lidhje me ndonjë detyrim financiar prej 500.000 lekësh ndaj znj. P. M.

54. Me qëllim qartësimin dhe saktësimin e kohës së saktë të pagesave, përkatësisht shumave 3.000.000 lekë dhe 500.000 lekë, në pyetëtorin nr. 2, iu kërkua subjektit: (i) të sqarojë mospërputhjet sa i takon deklaratimeve në lidhje me kohën e likuidimit të shumës 3.000.000 lekë, e cila nuk dha ndonjë sqarim për sa i është kërkuar, por shpjegoi ndër të tjera se shtetasi A. M. kishte marrë leje të rregullt nga organet shtetërore për punimet e ndërtesës, e cila do të përfundonte në shkurt të vitit 2008, por që në fakt e ka ndërtuar në vitin 2010; (ii) të sqarojë faktin se pse në deklaratën noteriale datë 2.10.2014, shtetasja P. M. nuk e kishte deklaruar marrjen e shumës prej 500.000 lekësh sipas mandatarkëtimit me këtë datë, pra 2.10. 2014, si dhe të paraqesë dokumentacion justifikues ligjor për të vërtetuar se kjo shumë është përdorur për blerjen e kësaj pasurie. Subjekti ka dhënë deklarime të paqarta në lidhje me sa i është kërkuar dhe paraqiti një fletë me shënime dore që nuk ka vlerën e një dokumenti shkresor.

55. Në përfundim të hetimit administrativ, në analizën financiare është konsideruar që vlera 3.000.000 lekë është paguar sipas aktmarrëveshjes me datë 19.2.2008, pra në këtë datë, referuar faktit që kjo marrëveshje është nënshkruar nga ish-pronari A. M. dhe mënyra e likuidimit e përcaktuar në këtë akt shkresor të lidhur në kohë reale, është më e besueshme se deklarata noteriale e datës 2.10.2014, e lëshuar nga bashkëshortja e tij P. M. Për më tepër, deklaratimet e subjektit kanë qenë shpesh kontradiktore.

56. Sa i takon shumës së paguar të pretenduar në datën 2.10.2014 prej 500.000 lekësh, nuk ka të dhëna nëse kjo shumë është paguar për blerjen e kësaj pasurie, por Komisioni duke iu referuar deklaratimeve të subjektit, e ka përfshirë këtë shumë si shpenzim në vitin 2014.

Analiza financiare për blerjen e njësisë

57. Bazuar në vetëdeklarimet e subjektit të rivlerësimit, si edhe në dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë: (i) për periudhën 1.1.2008 – 19.2.2008, me qëllim evidentimin e mundësisë financiare për kryerjen e pagesës në shumën 3.000.000 lekë; (ii) për periudhën 1.1.2014 – 2.10.2014 për kryerjen e pagesës në shumën 500.000 lekë, të pasqyruar në tabelat nr. 4 dhe nr. 5 si më poshtë:

Tabela nr. 4

	Datë 19.2.2008
A) PASURI	3,103,897
Njësi dyqan me sip. 34,5 m ² , e ndodhur në Shkodër, z. k. ***, realizuar aktmarrëveshje datë 19.2.2008, sipas së cilës është paguar vlera prej 3.000.000 lekësh.	3,000,000
Ndryshim likuiditeti	103,897
B) DETYRIME	0
C) PASURI NETO (A-B)	3,103,897
D) TË ARDHURA	272,005

Të ardhura nga paga e SR	103,486
Të ardhura nga paga e bashkëshortit të SR	22,708
Të ardhura nga ushtrimi i aktivitetit të bashkëshortit të SR	145,811
E) SHPENZIME	73,363
Shpenzime minimale jetike	73,363
Balanca e fondeve (D-C-E)	-2,905,255

Tabela nr. 5

	Datë 2.10.2014
A) PASURI	275,169
Njësi dyqan me sip. 34,5 m ² , e ndodhur në Shkodër, paguar 500,000 lekë, në datën 2.10.2014.	500,000
Ndryshim likuiditeti	-224,831
B) DETYRIME	0
C) PASURI NETO (A-B)	275,169
D) TË ARDHURA	1,854,680
Të ardhura nga paga e SR	1,188,850
Të ardhura nga paga e bashkëshortit të SR	146,195
Të ardhura nga ushtrimi i aktivitetit të bashkëshortit të SR	230,730
Të ardhura nga interesat e depozitës me afat në “Raiffeisen Bank”	132,300
Të ardhura nga interesat e depozitës me afat në “Tirana Bank”	156,605
E) SHPENZIME	738,114
Shpenzime minimale jetike	659,994
Shpenzime shkollimi për personin e lidhur J. R.	38,220
Shpenzime shkollimi për personin e lidhur G. R.	39,900
Balanca e fondeve (D-C-E)	841,397

58. Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të dhënë argumente dhe prova në lidhje me konstatimin, duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën e shumës prej 3,000,000 lekë (kësti i parë) të pasurisë objekt vlerësimi në datën 19.02.2008, për shkak të një balance negative në shumën - 2,905,255 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

59. Në analizë të parashtrimeve të subjektit, rezultoi se:

- Fillimisht subjekti përpiqet të argumentojë se aktmarrëveshja e datës 19.2.2008 mes bashkëshortit dhe shtetasit A. M. është e paqartë dhe e pasaktë dhe se është deklaratë e njëanshme e ndërtuesit. Subjekti pretendon se kjo marrëveshje është përpiluar mes tyre për t'i dhënë formë shkresore marrëveshjes verbale që kishin me njëri-tjetrin. Sipas saj, këtë dukje e përforcon më shumë fakti që nuk është bërë në një formë të mirëfilltë noteriale, por nënshkrimet e tyre janë vërtetuar tek një noter. Subjekti pretendon se deri në datën 19.2.2008 është paguar një pjesë e shumës, pasi objekti nuk ka qenë i përfunduar, duke argumentuar se shtetasi K. R. rezulton abonent me nr. kontrate *** për energjinë elektrike dhe në detajet e abonentit vërehen shënimet ndryshim emri nga A. M. në K. R. në datën 27.3.2015, e sipas subjektit, punimet e ndërtesës që do të mbaronin për 10 ditë në muajin shkurt 2008, përfunduan

në vitin 2015¹⁸. Sipas saj, duket qartazi se ky ambient nuk është përdorur asnjëherë nga bashkëshorti i saj dhe ky fakt provohet me vlerën e tarifimit të energjisë elektrike.

- Në lidhje me kohën e pagesës së kështit të parë prej 3.000.000 lekësh, subjekti pretendon se provohet me deklaratën noteriale të shtetasës P. M., e cila ka deklaruar se bashkëshorti është likuiduar plotësisht në shumën 3.000.000 lekë dhe mënyra e likuidimit të kësaj shume është bërë me këste gjatë viteve 2007 – 2008 – 2009. Për këtë arsye subjekti kërkon që Komisioni të bëjë shpërndarjen e shumës në këto 3 vite, me nga 1.000.000 lekë.

- Në parashtrimet e saj, subjekti nuk paraqiti ndonjë provë në mbështetje të pretendimeve, por në seancën dëgjimore datë 12.4.2023 paraqiti disa dokumente shkresore¹⁹.

60. Në procesin e vendimmarrjes, Komisioni vlerësoi se argumentet e subjektit të rivlerësimit janë të pabazuara për sa kohë provohet që:

i) Aktmarrëveshja është nënshkruar nga të dyja palët, një prej të cilave është pronari i objektit, i ndjeri A. M., vërtetuar me autentifikim të nënshkrimeve nr. *** rep., datë 19.2.2018, nga noteri P. Z.

ii) Sipas të dhënave nga detajet e abonentit, rezulton se kontrata *** është çelur për herë të parë që në datën 31.3.2008, pra objekti ka qenë i përfunduar në vitin 2008 kur është lidhur marrëveshja. Në parashtrime subjekti nuk paraqiti dokumente për të mbështetur argumentet e saj sa i përket kohës kur është ndërtuar objekti. Në seancë dëgjimore solli dokumente që sipas saj, objekti nuk është ndërtuar në vitin 2008, por është ndërtuar në vitet 2013 ose 2015. Mbi bazën e të dhënave të këtyre dokumenteve, u krye një verifikim në sistemin *online* të ASIG-ut dhe rezulton që që në vitin 2007 objekti është i ndërtuar²⁰. Për më tepër, subjekti ka qenë kontradiktor në deklaratime sa i takon periudhës së ndërtimit.

iii) Në asnjë prej DPV-ve prej viteve 2007, 2008 dhe 2009 subjekti nuk ka deklaruar pakësim likuiditeti *cash* dhe as pagesa të kryera për pagimin e shumës 3.000.000 lekë, sikurse pretendon.

Për rrjedhojë, Komisioni çmon se pagesa e kështit të parë prej 3.000.000 lekësh është bërë në datën 19.2.2008 sipas parashikimit të marrëveshjes së kësaj date për të cilën edhe pas rishikimit të analizës financiare, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën, për shkak të një balance negative mbetet në shumën 2.905.255 lekë, siç është paraqitur nga Komisioni në rezultatet e hetimit dërguar subjektit.

Gjithashtu, subjekti nuk ka kryer asnjë deklaram në DPV në lidhje me këtë pasuri dhe pagesat e kryera për blerjen e saj që në vitin 2008. Pretendimi i subjektit se nuk ka qenë në dijeni për shkak se me blerjen është marrë bashkëshorti, ndërkohë që pasuria nuk është përdorur, nuk mund të justifikojë mungesën e deklaratimeve në deklaratimet periodike sipas detyrimeve ligjore të pasurive të përfituara prej saj dhe personit të lidhur, të cilat sipas nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 janë prova nëpërmjet të cilave Komisioni verifikon pasuritë e subjekteve të rivlerësimit. Nga ana tjetër është e paqartë përse subjekti mungon të ketë kryer deklaratime në lidhje me këtë pasuri në DPV-në e vitit 2014 (pasi gjatë këtij viti ka dhënë deklaratime në ILDKPKI), ashtu sikurse edhe në deklaratat në vijim për vitet 2015 dhe 2016. Ndonëse referuar rrethanave, mosdeklaratimet e subjektit nuk vlerësohet se kanë sjellë si pasojë fshehjen e

¹⁸ Ndërkohë, në pyetësorin nr. 2 subjekti ka deklaruar: "... shtetasi A. M. kishte marrë leje të rregullt nga organet shtetërore për punimet e ndërtesës e cila do të përfundonte në shkurt të 2008, por që në fakt e ka ndërtuar në vitin 2010".

¹⁹ Shihni: kopje të praktikës së lejes së ndërtimit nr. *** prot., sipas shkresës nr. *** prot., datë 7.4.2023, të Bashkisë Shkodër; leje ndërtimi nr. *** prot., për shtetasin A. M. për objektin dyqane 2 kat; leje përdorimi nr. *** prot., datë 21.6.2013 për objektin 2 kat dyqane për shtetasin A. M., certifikatë pronësie datë 28.6.2013 sipas së cilës pasuria nr. ***, ndërtesa 2 kat me sip. 4300 m² ndërtesë, figuron në pronësi të trashëgimtarëve (bashkëpronarëve M.); kartela e pasurisë nr. *** me shënimet se kjo pasuri është ngritur mbi pasuritë nr. ***, ***, ***, ***, etj.; si dhe dokumentacion hartografik.

²⁰ <https://geoportal.asig.gov.al>

pasurisë, ato kanë vështirësuar verifikimet në lidhje me këtë pasuri, investimet dhe pagesat e kryera për të, fakt që i bën të pamjaftueshme deklaratimet në kuptim të ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me një konflikt interesi

61. Pas kërkimeve për një konflikt të mundshëm interesi, rezultoi se subjekti ka trajtuar çështjen me nr. ***, datë 9.3.2011, ku palë pjesëmarrëse kanë qenë trashëgimtarët e shtetasit A. M.²¹. Nga aktet e administruara rezultoi se:

- Sipas vendimit nr. ***, datë 9.3.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me gjyqtare subjektin e rivlerësimit, rezultoi se: shtetasi Gj. M. ka paditur trashëgimtarët ligjorë të shtetasit A. M., me objekt shpërblimin e dëmit nga humbja e pësuar dhe fitimi i munguar.

- Seanca gjyqësore e datës 25.2.2011 është shtyrë, pasi gjykata konstatoi se padia ka të meta dhe i kërkon paditësit të plotësojë të metat, duke përcaktuar të paditurin me emër dhe duke përcaktuar adresën e tij.

- Në seancë përgatitore të datës 9.3.2011, paditësi ka kërkuar kthimin e akteve, pasi nuk ka mundur të plotësojë të metat e padisë.

- Subjekti, me vendimin 9.3.2011, vendosi kthimin e padisë me aktet bashkëngjitur palës paditëse Gj. M. dhe ky vendim t'i komunikohet palës së paditur trashëgimtarëve ligjorë të shtetasit A. M.

62. Bazuar në nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile, gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete kur: “1. *Ka interes në çështje ose në një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me atë në gjykim;*... 3. *Ai vetë ose bashkëshortja e tij janë në konflikt gjyqësor ose në armiqësi apo në marrëdhënie kredie apo huaje me njërin prej palëve, ose njërin prej përfaqësuesve;*... 6. *Në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie*”. Në nenin 73, parashikohet se: “*Gjyqtari, i cili vlerëson me ndërgjegje se ka shkaqe të arsyeshme për të mos marrë pjesë në shqyrtimin e një çështjeje, i kërkon kryetarit të gjykatës zëvendësimin e tij...*”. Bazuar në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, neni 3, pika 1: “*Konflikt i interesit*” është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejta ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike”. Në nenin 5, pika 1/b e këtij ligji, parashikohet se interesat privatë të zyrtarit janë ata interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile.

63. Bazuar në sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e konfliktit të interesit, pasi ka qenë në një marrëdhënie juridiko-civile me palën e paditur, konkretisht P. M., trashëgimtare ligjore e shtetasit A. M. Subjekti i rivlerësimit duhet të kërkonte dorëheqjen nga shqyrtimi i çështjes, gjë që nuk e ka bërë, duke vepruar në kundërshtim me parashikimet e neneve 72 dhe 73 të Kodit të Procedurës Civile. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, iu kërkua subjektit të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

64. Në parashtrimet e saj subjekti, pasi sqaroi edhe njëherë në lidhje me rrethanat e evidentuara edhe nga Komisioni në rezultatet e hetimit duke iu referuar vendimit nr. ***, datë 9.3.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër “për kthimin e akteve”, pretendoi se ndryshe nga sa ka konstatuar Komisioni, ajo nuk e ka gjykuar këtë çështje dhe se konform nenit 154, gjykata

²¹ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 9.9.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në dosjen e Komisionit, bashkëngjitur vendimin nr. ***, datë 9.3.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër i formës së prerë. Sipas kësaj shkrese, verifikimi është kryer për periudhën 1998 e në vijim dhe dokumentacioni i mëparshëm është dëmtuar nga djegia në vitet 1997 e 1998.

duhej patjetër të identifikojë saktë palët ndërgjyqëse, dhe më pas çmon nëse është në kushtet e parashikuara nga neni 72 i Kodit të Procedurës Civile.

64.1. Në procesin e vendimmarrjes, Komisioni vlerëson se subjekti nuk argumentoi bindshëm se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit në çështjen civile të vitit 2011 për të cilën i kaloi barra e provës. Ndryshe nga sa pretendon subjekti, Komisioni nuk ka konstatuar se ajo e ka gjykuar këtë çështje, por që e ka shqyrtuar atë duke dhënë vendim jopërfundimtar²² për kthimin e padisë me aktet bashkëngjitur. Komisioni mban në konsideratë se parashikimi në nenin 154 të Kodit të Procedurës Civile, ku kërkohet të identifikohej saktë palët ndërgjyqëse, është një kusht formal i domosdoshëm për hartimin e padisë, por pavarësisht këtij kushti, me paraqitjen e padisë në rastin konkret, subjekti ka qenë në dijeni të plotë se palë e paditur janë trashëgimtarët e shtetasit A. M. me të cilin bashkëshorti kishte pasur marrëdhënie juridiko-civile të papërfunduar, e vijuar me mosmarrëveshje (sipas deklarimeve të subjektit, pasi palët nuk kanë rënë dakord për çmimin) me trashëgimtarin e tij P. M.

65. Bashkëlidhur parashtrimeve subjekti ka paraqitur një kërkesë të saj me date 25.1.2013 për heqje dorë nga gjykimi i një tjetër çështjeje civile nr. ***, e cila i ka kaluar për gjykim me datë 8.11.2012. Nga përmbajtja e kërkesës rezulton se pala e paditur P. M., administratore e shoqërisë “***” sh.p.k.²³, me datë 14.1.2013 ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e subjektit të rivlerësimit në këtë gjykim, me pretendimin se nga bashkëshorti i subjektit me profesion noter, kanë pasur dhe kanë raporte pune duke kryer veprime me këtë shoqëri. Subjekti sqaron se pasi e ka pyetur bashkëshortin për pretendimet e ngritura, ka çmuar se është e domosdoshme të heqë dorë konform neneve 72 dhe 73 të Kodit të Procedurës Civile. Kjo kërkesë është miratuar nga Kryetari i Gjykatës me vendim datë 28.1.2013, ku është cituar ndër të tjera se *...nga noteri K. R. ndër vite është mbajtur e gjithë praktika e shoqërisë “***” sh.p.k., ...çdo prokurë e nevojshme të kryhej nga ana e shoqërisë “***” sh.p.k. është përfunduar pranë noterit K. R.*

65.1. Sa i takon kërkesës për heqje dorë nga gjykimi të subjektit në çështjen civile nr. ***, me datë 25.1.2013, duke qenë se nuk ka të dhëna nëse subjekti ka kryer ndonjë veprim procedural para kësaj dorëheqjeje, për Komisionin mbetet e paqartë përse subjekti nuk ka kërkuar vetë dorëheqjen që në datën kur i ka kaluar çështja për gjykim, por është dashur të paraqesë kërkesë për përjashtim vetë pala e paditur, dhe vetëm pas nëntë ditësh subjekti ka dhënë dorëheqjen.

66. Në përfundim të procesit, Komisioni vlerëson se: (i) ekzistenca e një marrëdhënieje konfliktuale me palën e paditur P. M.; (ii) fakti që sipas vetë deklarimeve të subjektit dhe rrethanave të vërtetuara gjatë hetimit administrativ ajo dhe znj. M. kanë qenë në një marrëdhënie juridike civile shitjeje të papërfunduar në periudhat kur ka marrë për gjykim çështjet civile (shihni paragrafët 61-65.1 të këtij vendimi); si dhe, (iii) fakti që bashkëshorti i subjektit K. R. ndër vite ka mbajtur praktikën e shoqërisë “***” sh.p.k. me administratore P. M., vlerësohen mjaftueshëm si arsye serioze njëanshmërie dhe shkaqe të arsyeshme për të mos marrë pjesë në shqyrtimin e të dyja çështjeve civile duke hequr dorë prej tyre (ajo e referuar nga Komisioni, si dhe ajo e referuar nga subjekti), sipas neneve 72 e 73 të Kodit të Procedurës Civile. Për më tepër, këto dispozita ligjore dhe as dispozitat përkatëse të ligjit “Mbi konfliktin e interesit” nuk e kushtëzojnë dorëheqjen me vijimësinë apo përfundimin e çështjeve sikurse subjekti pretendon. Në këto kushte, subjekti ka pranuar për gjykim çështjet civile në kushtet e konfliktit të interesit me palën e paditur, përkatësisht znj. P. M. si trashëgimtare e shtetasit A. M. dhe si përfaqësuese e shoqërisë “***” sh.p.k.

²² Neni 127 i Kodit të Procedurës Civile: *“Vendimet jopërfundimtare janë vendimet e pushimit të çështjes, me të cilët gjykata ose gjyqtari në rastet e parashikuara në këtë Kod i japin fund procesit gjyqësor civil pa e zgjidhur çështjen në themel, si dhe çdo vendim tjetër që pa e zgjidhur çështjen në themel i jep fund procedimit gjyqësor të filluar”.*

²³ Nga verifikimi në sistemin e QKB-së rezulton se në shoqërinë “***” sh.p.k. e regjistruar në vitin 2006 ka qenë ortak shtetasi A. M., ndërsa në vitin 2010 është larguar shtetasi A. M. dhe është bërë ortak në këtë shoqëri shtetasja P. M. me fëmijët.

67. Depozitë pranë “Raiffeisen Bank”, çelur dhjetor 1995, fillimisht në emrin e subjektit (Izabela B.) në vlerën 500.000 lekë, shtuar vetëm me depozita interesa bankare, të dy së bashku, aktualisht kaluar në emër të bashkëshortit, bashkëngjitur dokumentacioni përkatës. Vlera: 3.760.408,81 lekë. Pjesa takuese: 50%. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këtë pasuri. Gjatë hetimit administrativ është verifikuar deklarimi i kësaj pasurie ndër vite, si dhe historiku i krijimit nëpërmjet të dhënave bankare, pasqyruar në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ. Në përfundim të hetimit administrativ rezultoi se:

- Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë në deklaratën e rivlerësimit kalimtar të dhënat lidhur me gjendjen e llogarisë depozitë pranë “Raiffeisen Bank”.

- Në momentin e dorëzimit të deklaratës fillestare të pasurisë – 2003, në llogari të subjektit të rivlerësimit kanë qenë të investuara shumat 2.227.449 lekë dhe 490.295 lekë, në total në vlerën 2.717.744 lekë, ndërsa në periudhën 2004 – 2016 subjekti dhe personi i lidhur kanë përfutur interesa në vlerën 1.587.631 lekë, të cilat në pjesën më të madhe janë akumuluar me investimin fillestar dhe në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka pasur gjendje në llogarinë bankare/depozitë në “Raiffeisen Bank”, në total shumën 3.760.408 lekë.

67.1. Bazuar në vetëdeklarimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe në dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për periudhën 1.1.1996 – 31.12.2003, me qëllim evidentimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për kryerjen e investimit në shumat 2.227.449 lekë dhe 490.295 lekë, në total 2.717.744 lekë, si dhe të shpenzimeve/investimeve të tjera të kryera për të njëjtën periudhë kohore, të pasqyruar në tabelën nr. 6 si më poshtë²⁴.

Tabela nr. 6

	Periudha 1996 - 2003
A) PASURI	5,817,744
Apartament me sip. 76 m ² , H. ***, K. ***, ndodhur në rrugën “****”, Shkodër, në vlerën 1.300.000 lekë, në datën 3.8.1996 nga shtetasi D. P.	1,300,000
Shtëpi banimi, apartament, me sip. 76 m ² , nr. pasurie ***, z. k. ***, adresa lagjja “****”, rruga “****”, p. nr. ***, Shkodër. Pagar vlera 1.800.000 lekë më 15.12.1998.	1,800,000
Ndryshim likuiditeti	2,717,744
B) DETYRIME	-
C) PASURI NETO (A-B)	5,817,744
D) TË ARDHURA	7,983,871
Të ardhura nga paga e SR	2,680,615
Të ardhura nga paga e bashkëshortit të SR	498,278
Të ardhura nga ushtrimi iu aktivitetit të bashkëshortit të SR (fitimi <i>neto</i>)	4,711,682
Të ardhura nga interesat e depozitës me afat në “Raiffeisen Bank”/Banka e Kursimeve	93,296
Të ardhura nga shitja e apartamentit me sip. 76 m ² , H. ***, K. ***, ndodhur në rrugën “****”, Shkodër, në vlerën 1.350.000 lekë në datën 7.6.1997 shtetasit R. P.	0
E) SHPENZIME	2,546,827
Shpenzime minimale jetike	2,228,827
Shpenzime mobilimi	318,000
Balanca e fondeve (D-C-E)	-380,700

²⁴ Të ardhurat nga shitja e apartamentit në datën 7.6.1997 në çmimin 1.350.000 lekë, nuk janë konsideruar të ligjshme për shkaqe të referuara në paragrafin 46.

67.2. Në përfundim të hetimit administrativ, duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin fillestar të kësaj pasurie deri në vitin 2003 për shkak të një balance negative fondesh në vlerën – 380.700 lekë, ndërsa nga ana tjetër nuk gjendet në pamundësi financiare për shtesat e evidentuara nga interesat vjetore në këtë depozitë deri në vitin 2016. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të dhënë argumente dhe prova në lidhje me këtë konstatim. Në parashtrimet e saj subjekti nuk dha ndonjë sqarim specifik në lidhje me këtë konstatim, por ka pretenduar që nga ana e Komisionit për periudhën 1996 – 2003 të reflektohen edhe disa të ardhura nga burime të tjera: (a) të ardhurat në vlerën 1.350.000 lekë nga shitja e pasurisë së llojit apartament të ndodhur në Shkodër në datën 7.6.1997; (b) të ardhurat e përfituara familjarisht si ish të persekutuar në vlerën 1.000.000 lekë; (c) të ardhurat nga pensioni familjar i babait për periudhën 1992 – 1996 në vlerën 71.394 lekë; dhe (ç) të ardhurat nga paga e personit të lidhur për periudhën 1991 – 1996 në vlerën 604.000 lekë.

67.3. Në përfundim, në analizë të pretendimeve të subjektit, vlerësohet se: (i) të ardhurat e pretenduara nga shitja e apartamentit në vlerën 1.350.000 lekë nuk janë konsideruar si të ardhura të ligjshme (trajtuar në paragrafët nr. 34.3 dhe nr. 41); (ii) të ardhurat e pretenduara familjarisht si ish të persekutuar në vlerën 1.000.000 lekë nuk janë konsideruar gjithashtu (trajtuar në paragrafin nr. 43); (iii) të ardhurat nga pensioni familjar i babait në vlerën 71.394 lekë nuk janë reflektuar në analizën financiare, pasi përfitimi i tyre rezulton të ketë qenë për të gjithë familjarët e subjektit, janë përfituar për një periudhë të hershme për vitet 1992 – 1996 dhe janë në vlerë të papërfillshme në krahasim me balancën negative të evidentuar nga Komisioni në rezultatet e hetimit administrativ; (iv) të ardhurat nga paga e personit të lidhur për periudhën 1991 – 1996 në vlerën 604.000 lekë janë të një periudhe më të hershme, si dhe janë pretenduar si burim krijimi edhe për pasurinë e krijuar nga subjekti në vitin 1998 dhe, si të tilla, janë reflektuar në analizën financiare të kryer për blerjen e pasurisë deri në datën 15.12.1998 (trajtuar në paragrafin nr. 44). Pas rishikimit të analizës financiare, Komisioni përfundimisht çmon se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin fillestar të kësaj pasurie deri në vitin 2003 për shkak të një balance negative fondesh në vlerën – 380.700 lekë.

68. *Depozitë pranë “Tirana Bank”, çelur në qershor 2013, burimi nga të ardhura nga paga dhe interesa, në emrin e subjektit aktualisht, bashkëngjitur dokumentacioni përkatës. Vlera: 3.259.917 lekë. Pjesa takuese: 100%. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këtë pasuri. Gjatë hetimit administrativ është verifikuar deklarimi i kësaj pasurie ndër vite, si dhe historiku i krijimit nëpërmjet të dhënave bankare, pasqyruar në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ. Në përfundim të hetimit administrativ rezultoi se:*

- Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë në deklaratën e rivlerësimit kalimtar të dhënat lidhur me gjendjen e llogarisë depozitë, pranë “Tirana Bank”.

- Në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka pasur llogari bankare – depozitë në “Tirana Bank”, të evidentuar si më sipër, në total shumën 3.259.917 lekë.

68.1. Bazuar në vetëdeklarimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për periudhën 2005 – 31.12.2016, me qëllim evidentimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për kryerjen e investimit dhe të shtesave të kredituara në këtë llogari për çdo vit, si dhe mbulimin e shpenzimeve/investimeve të tjera të kryera për të njëjtën periudhë kohore, të pasqyruar në tabelën nr. 7 si më poshtë:

Tabela nr. 7

	2008	2010	2011
A) PASURI	3,153,140	1,087,812	1,139,293

Autovetura tip "Daimler Chrysler", me targa ***.	425,774		
Njësi dyqan me sip. 34,5 m ² , e ndodhur në Shkodër.	3,000,000		
Ndryshim likuiditeti	-272,634	1,087,812	1,139,293
B) DETYRIME	0	0	0
C) PASURI NETO (A-B)	3,153,140	1,087,812	1,139,293
D) TË ARDHURA	2,208,125	1,634,065	1,722,494
Të ardhura nga paga e SR	977,740	1,116,902	1,160,142
Të ardhura nga paga e bashkëshortit të SR	144,240	167,742	174,456
Të ardhura nga ushtrimi i aktivitetit të bashkëshortit të SR	1,086,145	180,000	217,927
Të ardhura nga interesat e depozitës me afat në "Raiffeisen Bank"		169,421	169,969
E) SHPENZIME	589,369	558,571	811,322
Shpenzime minimale jetike	546,480	546,480	546,480
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit	42,889	12,091	264,842
Balanca e fondeve (D-C-E)	-1,534,384	-12,318	-228,121

68.2. Në përfundim të hetimit administrativ, duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin/shtesat e likuiditeti të kryera në këtë llogari për vitet 2008, 2010 dhe 2011, si dhe kryerjen e shpenzimeve/ investimeve të tjera të deklaruara dhe/apo të evidentuara për të njëjtën periudhë duke rezultuar me balancë negative fondesh në shumën 1.774.823 lekë. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të kundërshtuar këtë konstatim.

68.3. Në parashtrimet e saj subjekti nuk dha ndonjë sqarim specifik në lidhje me këtë konstatim, por ka pretenduar ndër të tjera që të ardhurat e realizuara nga bashkëshorti për vitet 2008, 2010 dhe 2011 të ripërlllogariten nga Komisioni sipas qarkullimit dhe fitimit të mundshëm të realizuar sipas regjistrave²⁵ fizikë të akteve dhe veprimeve të aktivitetit noterial të personit të lidhur K. R. për këto vite dhe jo duke u bazuar në deklaratimet e kryera prej tij si person fizik në organet tatimore përkatëse për të njëjtën periudhë kohore. Nga ana tjetër, subjekti ka pretenduar se balanca negative e fondeve për vitin 2008 është e lidhur me mënyrën e pasqyrimin të shlyerjes së çmimit për pasurinë tjetër të blerë brenda të njëjtit vit kalendarik e konkretisht për njësinë tregtare me sip. 34.5 m², të ndodhur në Shkodër, duke kundërshtuar pagesën e kryer prej 3.000.000 lekësh në këtë vit përkundrejt vlerës së pretenduar prej 1.000.000 lekësh. Përfundimisht, Komisioni konkludoi se të ardhurat e krijuara nga personi i lidhur do të vlerësohen vetëm ato të cilat janë konfirmuar nga organet tatimore sipas vetëdeklarimit të personit të lidhur në cilësinë e personit fizik, dhe se, në analizën financiare shlyerja e çmimit për blerjen e pasurisë të llojit "njësi tregtare" me sip. 34.5 m² do të reflektohet në vlerën 3.000.000 lekë, siç është trajtuar gjerësisht në pikat 51-60 të këtij vendimi. Edhe me rishikimin e analizës financiare, në përfundim, nuk ka ndryshim të balancës negative të njoftuar me rezultatet e hetimit administrativ.

69. Llogari bankare në "Tirana Bank" në emrin e subjektit, në gjendje deri më 27.1.2017. Burimi i krijimit nga të ardhurat nga paga e punës, bashkëngjitur dokumentacioni përkatës. Vlera: 556.089,11 lekë. Pjesa takuese: 100 %. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këtë pasuri. Gjatë hetimit administrativ është verifikuar deklarimi i kësaj pasurie ndër vite, si dhe historiku i krijimit nëpërmjet të dhënave bankare, pasqyruar në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ. Në përfundim të hetimit administrativ rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë në deklaratën e rivlerësimit kalimtar të dhënat lidhur

²⁵ Shihni prapësimet e dërguara nga subjekti pas njohjes me rezultatet e hetimit.

me gjendjen e llogarisë pranë “Tirana Bank”, dhe se, nuk lindin dyshime për mënyrën e krijimit të kësaj shume, e cila është akumulimi i pagave në llogari bankare.

70. *Cash në shtëpi, për nevoja të ndryshme, burimi të ardhurat nga puna e të dy bashkëshortëve. Vlera: 300.000 lekë. Pjesa takuese: 50 %. ILDKPKI-ja ka konstatuar se subjekti ka të ardhura për të mundësuar krijimin e gjendjes cash. Gjatë hetimit administrativ është verifikuar gjendja cash në fund të çdo viti bazuar në deklaratimet e subjektit, të cilat kanë qenë të sakta, si dhe në të dhënat bankare, pasqyruar në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ. Në përfundim të hetimit rezultoi se gjatë viteve që subjekti dhe personi i lidhur kanë deklaruar shtesat e shumave cash, nuk rezultojnë të jenë në pamundësi financiare.*

71. *Një shtëpi banimi pasuri nr. *** e ndodhur në z. k. ***, me sip. trualli 154.75 m², në adresën rruga “***”, burimi trashëgimi me 1/5 pjesë takuese, bashkëngjitur dokumentacioni. Vlera: s’ka. Pjesa takuese: 1/5. ILDKPKI-ja ka konstatuar mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me mënyrën e përfitimit të pjesës takuese 1/5 në shtëpi banimi (1 dhe 2 kate) me sip. 154.75 m², në Shkodër, në pronësi të nënës së subjektit.*

72. Nga aktet²⁶ në dosje rezultoi se:

- Sipas vërtetimit hipotekor të datës 6.9.2012, në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 6.9.2012, figuron në pronësi të shtetas L. K. B. (nëna e subjektit), pasuria nr. ***, z. k. ***, truall me sip. 154.75 m², ndërtesë 1 dhe 2 kat. ASHK Shkodër²⁷ nuk ka konfirmuar pronësinë në emër të subjektit.

- FSHU-ja nuk ka konfirmuar të ketë kontratë të lidhur nga subjekti apo bashkëshorti për këtë pasuri, por subjekti²⁸ ka paraqitur librezën e energjisë elektrike për kontratën me nr. ***, në emër të shtetas L. B.

- Në pyetësin nr. 2, iu kërkua subjektit të japë informacion për origjinën e kësaj pasurie, bashkëpronarët e saj, kohën dhe mënyrën e fitimit të bashkëpronësisë nga ana e saj, duke shoqëruar me dokumentacion justifikues ligjor, e cila deklaroi se: *...ndërtesa është bërë që në vitin 1988 dhe përfunduar në vitin 1990, në oborrin e shtëpisë të regjistruar në bashkëpronësi dhe me xhaxhallarët L. B., Z. B. dhe halla V. B., ndërsa në emër të babait të saj ka qenë e regjistruar vetëm një dhomë e kuzhinë e shtëpisë së vjetër, regjistruar në vitin 1926 dhe pjesëtuar me vendim gjykate. Ndërtesa është bërë me forcat e tyre pasi kanë qenë 5 fëmijë me një dhomë e kuzhinë. Dy vëllezërit V. dhe E. kanë qenë murator, vëllai tjetër A. me profesion hidraulik ndërsa Gj. me profesion saldator. Banesën e kanë poseduar dhe vazhdojnë ta posedojnë dy vëllezërit e saj... Kjo pasuri është vetëdeklaruar për legalizim në vitin 2006 nga nëna e subjektit L. B. Për një pjesë janë bërë pagesat në bono dhe një pjesë në lekë, si dhe është realizuar kontrata e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore në vitin 2012. Më pas është lëshuar leja e legalizimit nr. *** datë 30.5.2012 për objektin godinë banimi 2 kt, nr. pasurie *** me sip. 154.75 m², e regjistruar në emrin e nënës së subjektit, në adresën rrugën “***”, Shkodër... Me vdekjen e nënës së subjektit datë 9.4.2014, në vitin 2015 ka deklaruar 1/5 duke qenë ajo me vëllezërit janë trashëgimtarë, por nuk e kanë çelur akoma dëshminë e trashëgimisë.*

72.1. Subjekti paraqiti fotokopje të: vetëdeklarimit të bërë nga shtetasja L. B. datë 2.11.2006; kontratë të kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore nr. ***, datë 28.5.2012, me blerës L. B.; leje legalizimi nr. ***, datë 30.5.2012, në emër të shtetas L.B.

73. Edhe pse subjekti dha shpjegime në lidhje me origjinën e kësaj pasurie, nuk ka paraqitur dokumente shkresore për të vërtetuar deklaratimet e saj dhe as dokumentacion justifikues ligjor për të vërtetuar pjesën e deklaruar prej 1/5, mbi këtë pasuri. Me njoftimin e rezultateve të

²⁶ Shihni aneks 4/8 në dosjen ILDKPKI; shihni shkresën nr. *** prot., datë 16.11.2022, të ASHK-së Shkodër dhe shkresën nr. *** prot., datë 8.6.2021, të FSHU-së, në dosjen e Komisionit.

²⁷ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 16.11.2022, të ASHK Shkodër, në dosjen e Komisionit.

²⁸ Shihni email-in datë 24.2.2023 në dosjen e Komisionit.

hetimit, iu kërkua subjektit të japë sqarime të mëtejshme e dokumente në lidhje me statusin aktual të pasurisë, si dhe pjesën e saj takuese.

74. Në parashtrimet e saj, subjekti nuk dha asnjë sqarim, si dhe nuk paraqiti asnjë dokument. Nga ana tjetër, në procesin e vendimmarrjes, Komisioni mban në konsideratë faktin se për herë të parë në parashtrimet e saj, pas njohjes së rezultateve të hetimit, subjekti deklaroi se ka jetuar me familjen në këtë banesë, në kundërshtim me të gjitha deklaratimet e mëparshme, ku ka deklaruar se ka banuar në apartamentin me sip. 151 m² në pronësi të bashkëshortit të saj. Në këtë mënyrë subjekti nuk ka deklaruar posedimin/përdorimin e banesës private të nënës së saj objekt verifikimi sipas përcaktimeve të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës²⁹ dhe ligjit nr. 84/2016³⁰, por e ka deklaruar atë *post factum*, vetëm pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ (trajtuar hollësisht në paragrafin 27).

75. Në deklaratën *Vetting*, në rubrikën “përshkrimi i detyrimeve”, subjekti ka deklaruar kartë krediti në BKT në emrin e saj, në vlerën 150.000 lekë. Në përfundim të hetimit administrativ u vërtetua se përputhet deklarimi i subjektit me të dhënat bankare.

Deklaratë e pasurisë së personit të lidhur K. R., bashkëshorti i subjektit, i cili ka plotësuar deklaratën *Vetting* duke plotësuar autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave, ku ka evidentuar se ka pasuri veçmas të regjistruar në emrin e tij, si vijojnë.

76. *Shtëpi banimi, apartament, me sip. 75 m², nr. pasurie ***, z. k. ***, adresa lagjja “****”, rruga “****”, p. nr. ***, Shkodër. Pronësi e fituar me privatizim në vitin 1992 dhe më pas me akt dhurimi nga prindërit e bashkëshortit në datën 5.11.1997 dhe e regjistruar në emrin e tij, bashkëngjitur dokumentacioni përkatës. Vlera: 0 (zero). Pjesa takuese: 100 %. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këtë pasuri.*

77. Nga aktet në dosje³¹ rezulton se:

- Sipas aktit datë 5.11.1997, dhuruesit L. R., F. R. dhe L. R., bashkëpronarë të një apartamenti banimi me sip. 75 m², përfituar me privatizim, i dhurojnë pjesët e tyre takuese baahkëpronarit K. R.

- Sipas certifikatës së pronësisë datë 14.12.2010, pasuria nr. ***, e llojit apartament me sip. 75 m² figuron në pronësi të shtetasit K. R. ASHK Shkodër ka konfirmuar pasurinë nr. ***, apartament me sip. 75 m², në pronësi të shtetasit K. R..

- Në DPDFD 2003, subjekti ka deklaruar: shtëpi banimi apartament me sip. 75 m², vlera nuk është deklaruar, burimi i krijimit privatizim.

- Në DPV-në e vitit 2004, subjekti ka deklaruar: shtëpi banimi (apartament) sip. 151 m², ½ e kësaj prone përfituar nga privatizimi i banesave shtetërore (falas) në favor të bashkëshortit me akt dhurimi nga prindërit e tij (pasuria objekt verifikimi me sip. 75 m²). Pjesa tjetër me akt dhurimi (pasuria me sip. 76 m², trajtuar më sipër).

- Në pyetësorin nr. 2, iu kërkua subjektit të informojë se nga kush janë përdorur dy apartamentet dhe periudhat përkatëse, e cila fillimisht informoi se, janë po ato apartamente me sip. 75 dhe 76 m², pasi janë bashkuar në regjistrim pranë ASHK Shkodër dhe kur është bërë rivlerësimi i tyre, janë ndarë dhe regjistruar po përsëri si dy apartamente. Në mbështetje të këtij sqarimi subjekti ka paraqitur fotokopje vërtetimi pronësie³² Shkodër datë 15.4.1999, sipas së

²⁹ “Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklaratimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim...”.

³⁰ Neni 3, pika 11: “Pasuri janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, ‘Për deklaratimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë’, i ndryshuar që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit”.

³¹ Shihni aneks 4/10 dhe aneks 28 në dosjen ILDKPKI dhe shkresën nr. *** prot., datë 16.11.2022, të ASHK-së Shkodër; shkresën nr. *** prot., datë 8.6.2021, të FSHU-së, në dosjen e Komisionit.

³² Shihni dokumentet e paraqitur në përgjigje të pyetësorit nr. 2. Subjekti ka paraqitur edhe dokumentacionin e origjinës për apartamentin me sip. 75 m².

cilës në favor të shtetasit K. R. është regjistruar apartamenti me sip. 151 m² në adresën lagjen “***”, rruga “***”, p. ***, k. ***. Sa i përket përdorimit të tyre, subjekti informoi se apartamenti me sip. 75 është përdorur nga prindërit e bashkëshortit deri sa kanë ndërruar jetë dhe nga motra e bashkëshortit vetëm në periudha tremujore, ku ka qëndruar në Shqipëri pasi ajo është shtetase australiane. Apartamenti me sipërfaqe prej 76 m² është përdorur vetëm nga subjekti me bashkëshortin dhe dy fëmijët. Pas ndërrimit të jetës së prindërve të bashkëshortit, të dy apartamentet përdoren vetëm nga familja e subjektit.

78. Sa më sipër, në përfundim të hetimit administrativ, nuk u konstatuan problematika në lidhje me origjinën dhe mënyrën e fitimit të pronësisë me privatizim dhe dhurim.

79. *Shtëpi banimi, apartament, me sip. 76 m², nr. pasurie ***, z. k. ***, trajtuar më lart; autovetura tip “Daimler Chrysler”, me targa ***, trajtuar më lart; njësi dyqan me sip. 34.5 m², trajtuar më lart; depozitë pranë “Raiffeisen Bank” çelur në dhjetor 1995, trajtuar më lart; cash në shtëpi, për nevoja të ndryshme, burimi të ardhurat nga puna e të dy bashkëshortëve. Vlera: 300.000 lekë. Pjesa takuese: 50 %, trajtuar më lart.*

Deklaratë e pasurisë së personit të lidhur G. R., djali i subjektit, i cili në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* është pjesë përbërëse e familjes.

80. I biri ka plotësuar deklaratën *Vetting* duke plotësuar autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave, ku ka evidentuar se nuk ka pasuri veçmas të regjistruar në emrin e tij. Në deklaratën *Vetting*, në rubrikën të dhëna konfidenciale, ka deklaruar: *Student pranë Universitetit *** të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, dega Juridik. Për këtë arsimim është paguar nga prindërit vlera 2.000 euro nëpërmjet llogarisë bankare të “Tirana Bank”. Aktualisht jeton në banesë me qira në Tiranë tek Kodra e Diellit, së bashku me motrën dhe dy studente të tjera. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika. Gjatë hetimit administrativ u kryen disa verifikime, të cilat janë pasqyruar në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ dhe në përfundim të hetimit, nuk u konstatuan problematika në deklarimet e personit të lidhur – djalit të subjektit.*

Deklaratë e pasurisë së personit të lidhur J. R., e cila në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* është pjesë përbërëse e familjes.

81. E bija ka plotësuar deklaratën *Vetting* duke plotësuar autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave, ku ka evidentuar se ka pasuri veçmas të regjistruar në emrin e saj dhe ka deklaruar:

- *Depozitë pranë “C. Bank”, viti i krijimit 2016 në emër të shtetases J. K. R., burimi i kësaj llogarie-rimbursim për udhëtim të parapaguar nga prindërit, me ftesë të shoqërisë jofitimprurëse Kroaci, bashkëngjitur dokumentacioni përkatës. Vlera: 117.87 euro.*

- Në rubrikën “të dhëna konfidenciale”, ka deklaruar: *studente pranë Universitetit Tiranë, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, dega Anglisht, konvikt, si dhe ka paraqitur depozitë në arkë³³ datë 18.2.2016, të “Alpha Bank”, me përshkrimin “J. R. pagesë tarifë shkollim cikli i parë, viti i parë për F. Gj. të Huaja, në shumën 25.000 lekë”.*

82. Gjatë hetimit administrativ u kryen disa verifikime, të cilat janë pasqyruar në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ dhe në përfundim të hetimit, nuk u konstatuan problematika në deklarimet e personit të lidhur – vajzës së subjektit.

KONSTATIME TË TJERA

³³ Shihni aneks 4/14 në dosjen ILDKPKI.

83. Nga aktet në dosjen ILDKPKI, rezulton se ZVRPP-ja Shkodër³⁴ ka konfirmuar se në emër të Izabela Ç. Radovani ndodhet apartamenti me sip. 54 m², z. k. ***, në Shkodër (sipërfaqja është bazuar te shkresa e ZVRPP-së dhe kartela e pasurisë, por sipas kontratave me objekt këtë pasuri, sipërfaqja është 70 m²). ILDKPKI-ja ka konstatuar mosdeklarim të apartamentit me sip. 54 m², blerë nga Izabela B., në vitin 1996, në shumën 220.000 lekë, në deklaratat e interesave privatë dhe në deklaratën *Vetting*. Në deklaratat e subjektit nuk rezulton të jenë kryer deklarime në lidhje me këtë pasuri.

84. Nga dokumentet në dosjen ILDKPKI³⁵, rezulton se:

- Sipas akt shitblerjes së pasurisë nr. ***, datë 2.5.1996, shtetasit F. G., N. G., A. G., J. G. dhe K. G., i shesin shtetas Izabela B. (Radovani) një apartament banimi me sip. 70 m², në lagjen “****”, rruga “****”, në shumën 220.000 lekë, dorëzuar shitësve në dorë.

- Sipas kartelës së pasurisë nr. ***, apartamenti me sip. 54 m², në adresë rruga “****”, p. ***, sh. ***, k.***, ap. ***, Shkodër, figuron në pronësi të shtetas Izabela Ç. B. (Radovani). Në seksionin e pronësisë vërehet regjistrimi në vitin 1995 i pronësisë nga bashkëpronarët G. dhe kalimi tek Izabela Ç. B. (Radovani) me datë regjistrimi 7.3.2001.

- Sipas certifikatës personale datë 26.1.2017, subjekti rezulton me vendbanim në adresën: *Shkodër*, ***. Sipas certifikatës së martesës datë 14.8.2020, subjekti rezulton të jetë martuar më 24.10.1996, me shtetasin K. R., pra pas blerjes së apartamentit.

- Në asnjë prej DPV-ve subjekti nuk e ka deklaruar këtë banesë as si adresë banimi dhe as si adresë të gjendjes civile.

85. Gjatë hetimit administrativ:

- ASHK Shkodër³⁶ nuk e ka konfirmuar këtë pasuri në emër të subjektit të rivlerësimit.

- Në pyetësin nr. 2, iu kërkua subjektit të sqarojë në lidhje me mosdeklarimin e kësaj pasurie në DPV dhe në deklaratën *Vetting*, statusin/pronarin aktual të kësaj pasurie, burimin e krijimit, mospërputhjen e sipërfaqes prej 70 m² në akt shiteje me sipërfaqen prej 54 m² në kartelën e pasurisë duke paraqitur dokumentacion justifikues ligjor, si dhe të sqarojë në lidhje me personat që e kanë përdorur nga momenti i blerjes. Në përgjigje të këtij pyetësi, subjekti mohon të ketë lidhur kontrata me objekt këtë pasuri e, për rrjedhojë, nuk ka informacion mbi gjendjen aktuale juridike të kësaj pasurie. Sa i takon adresës së vendbanimit që sipas certifikatës personale është “*Shkodër*, ***”, e cila është edhe adresa e kësaj pasurie sipas të dyja kontratave të blerjes dhe të shitjes së pasurisë nga shtetasja Izabela Radovani (B.), subjekti deklaroi se kjo adresë nuk përputhet me vendbanimin e saj të regjistruar zyrtarisht në gjendjen civile dhe ka paraqitur dokument që vërteton adresën aktuale të saj të regjistrimit në gjendjen civile: Bulevardi “****”, nd. ***, h. ***, ap. ***, kodi postar ***. Kjo adresë është adresa e apartamentit të banimit ku ajo banon së bashku me bashkëshortin sot, deklaruar në deklaratën *Vetting*.

86. Në mbështetje të deklarimeve, subjekti paraqiti:

a. Vërtetim nxjerrje nga arkiva noteriale nga notere Dr. E. M., të kontratave: (i) akt shitblerje nr. ***, datë 2.5.1996, të noteres G. Ll. Sh, me palë shitëse bashkëpronarët G. dhe palë blerëse Izabela B. (Radovani), e bija e Ç. dhe L., datëlindje (nuk ka), për apartamentin e banimit me sip. 70 m², ndodhur në lagjen “****”, rruga “****”, me çmim shitjeje 220.000 lekë; (ii) akt shitblerjeje nr. ***, datë 28.5.1997, të noteres G. Ll. Sh., me palë shitëse Izabela B. (Radovani) e bija e Ç. e vitlindjes 1963 dhe blerës shtetasit G. N. dhe D. N., për apartamentin e banimit me sip. 70 m², ndodhur në lagjen “****”, rruga “****”, me çmim shitjeje 1.050.000 lekë.

³⁴ Shihni aneks 28 në dosjen ILDKPKI.

³⁵ Shihni aneks 28 në dosjen ILDKPKI.

³⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 16.11.2022, e ASHK-së Shkodër, në dosjen e Komisionit.

b. Inventar i brendshëm i dosjes të pasurisë ***, me nr. reference ***, të ASHK-së Shkodër. Në dokumentet e këtij inventari pasqyrohen veprimet hipotekore të kryera për pasurinë në fjalë, si dhe transaksionet e pasurisë, e cila figuron e regjistruar në emër të bashkëpronarëve B., pasqyruar në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ.

87. Me qëllim verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, Komisioni kreu veprime të mëtejshme hetimore si vijon:

- Iu kërkua noteres E. M. të vërë në dispozicion kontratat e shitjeve dhe dokumentet bashkëlidhur dhe çdo akt noterial ku palë pjesëmarrëse (në cilindo status) janë Izabela (B.) atësia Ç., dhe K. R. atësia L., J. K. R. dhe G. K. R., të redaktuara nga ana e noteres G. Sh. ose nga ana e saj. Kjo e fundit, me *email*-in datë 30.12.2022, vuri në dispozicion: (i) akt shitblerjeje nr. ***, datë 2.5.1996, bashkëngjitur akt shitblerjeje nr. ***, datë 17.12.1993, sipas të cilit F. G. etj., kanë blerë nga sektori i privatizimit të banesave apartamentin me sip. 70 m²; (ii) akt shitblerjeje nr. ***, datë 28.5.1997, bashkëngjitur akt shitblerjeje nr. ***, datë 2.5.1996.

- Komisioni iu drejtua sërish ASHK-së Shkodër duke i kërkuar të informojë se përse ZVRPP-ja Shkodër në vitin 2017 ka konfirmuar apartamentin me nr. pasurie ***, në emër të subjektit të rivlerësimit, si dhe të vërë në dispozicion dosjen e plotë të kësaj pasurie. Kjo e fundit³⁷ nuk dha informacion mbi arsyet e konfirmimit në pronësi në emër të subjektit të rivlerësimit në vitin 2017, por informoi mbi kalimet e pronësisë ashtu siç kishte informuar edhe subjektin e rivlerësimit, duke bashkëngjitur dokumentacionin e origjinës, ndër të tjera: radhorët e pronësisë ku janë pasqyruar regjistrimet e aktit nr. ***, datë 28.5.1997 dhe aktit nr. ***, datë 31.8.1998, me datë 31.8.1998, si dhe kopje të kartelës së pasurisë ku janë pasqyruar kalimet e pronësi tek familja G. tek Izabela Ç. B. (Radovani), N. B., H. B., etj.

- U kërkua informacion në ILDKPKI, e cila vuri në dispozicion procesverbalet e datave 26.5.2021 dhe 4.6.2021³⁸, ku subjekti është pyetur në lidhje me faktin se sistemi multifunksional i ASHK-së konfirmon në emër të shtetases Izabela Radovani (B.) pasurinë nr. *** dhe akt shitblerjen nr. ***, datë 2.5.1996. Sipas procesverbalit të datës 4.6.2021, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nuk ka pasur asnjëherë dijeni për këto veprime dhe se kjo pasuri nuk është në emrin e saj siç vërtetohet nga ASHK DV Shkodër.

88. Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në të gjitha provat e administruara, duket se subjekti ka kryer deklarime të paqarta dhe të pavërteta në lidhje me këtë pasuri, pasi:

- Referuar dy akteve shkresore të cilat nuk rezultojn të jenë shpallur të pavlefshme dhe janë regjistruar në zyrën përkatëse të noterisë, si dhe në ZVRPP Shkodër, u vërtetua se: (i) pala blerëse në kontratën e vitit 1996 është *Izabela B. (Radovani) e bija e Ç. dhe L.* Akti nuk ka datëlindjen e blerëses, por gjeneralitetet e tjera përputhen me ato të subjektit të rivlerësimit; (ii) pala shitëse në kontratën e vitit 1997 është *Izabela B. (Radovani) e bija e Ç., e vitlindjes 1963*, gjeneralitetet e së cilës përputhen plotësisht me ato të subjektit të rivlerësimit. Pavarësisht këtyre fakteve, subjekti mohon që ta ketë blerë dhe ta ketë shitur këtë pasuri; (iii) është e paqartë përse pasuria është shitur pas një viti sa pesëfishi i blerjes një vit më parë; (iv) sipas certifikatës personale me datë lëshimi 26.1.2017, subjekti rezultoi me vendbanim në adresën: *Shkodër, ****, e cila është edhe adresa e pasurisë objekt i të dyja kontratave të sipërpërmendura.

89. Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e këtyre konstatimeve, si dhe të vërtetojë me dokument shkresor të gjitha adresat e gjendjes civile dhe adresat e banimit, deri ditën e sotme. Pavarësisht që kontratat i përkisnin periudhës përpara detyrës, subjektit i është bërë me dije se qëndrimi saj në lidhje me këtë pasuri

³⁷ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 25.1.2023 të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Drejtoria Vendore Shkodër, në dosjen e Komisionit.

³⁸ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 7.2.2023, të ILDKPKI-së në dosjen e Komisionit.

do të mbahet në konsideratë nga Komisioni në marrjen e vendimit, në referim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

90. Në parashtrimet e saj, duke iu referuar vetëm kontratës së shitjes së pasurisë nr. ***, datë 2.5.1996, ku subjekti është në cilësinë e palës blerëse, subjekti pretendon se në mënyrë shteruese, me argumente dhe prova, ka vërtetuar që kjo kontratë dhe pronësia mbi këtë send të paluajtshëm, nuk kanë lidhje me të. Në mënyrë të përmbledhur subjekti pretendoi se:

90.1. Së pari: në këtë kontratën e datës 2.5.1996 nuk është identifikuar pala blerëse, pra subjekti, me gjeneralitete të plota dhe identifikuar me mjet identifikimi.

90.2. Së dyti: referuar datës së kësaj kontrate shitjeje, muaji maj 1996, rezulton se subjekti e ka mbiemrin B. dhe nuk kishte lidhur martesë. Mbiemrin Radovani subjekti e ka marrë në datën 24.10.1996 që përkon me lidhjen e martesës.

90.3. Së treti: nga hetimi i thelluar i realizuar nga Komisioni rezulton që subjekti nuk ka lidhur ndonjëherë kontratë me FSHU-në në këtë adresë.

90.4. Së katërti: sa i takon adresës së vendbanimit që sipas certifikatës personale është “Shkodër, ***”, e cila është edhe adresa e kësaj pasurie sipas të dyja kontratave, kjo adresë nuk përputhet me vendbanimin e saj të regjistruar zyrtarisht në gjendjen civile dhe ka paraqitur dokument që vërteton adresën aktuale të saj të regjistrimit në gjendjen civile: Bulevardi “****”, nd. ***, h. ***, ap. ***, kodi postar ***. Sipas subjektit, kjo adresë është adresa e apartamentit të banimit ku ajo banon së bashku me bashkëshortin sot, deklaruar në deklaratën *Vetting*.

90.5. Së pesti: pasi është njohur me kontratën e shitjes së pasurisë nr. ***, datë 2.5.1996, subjekti nëpërmjet ekspertëve të fushës ka vërtetuar shkencërisht faktin se nënshkrimi në këtë kontratë nuk duhet të jetë i saj. Bashkëlidhur ka paraqitur aktin nr. ***, datë 30.3.2023, për ekspertim grafik nënshkrimesh.

90.6. Së gjashti: kjo pasuri nuk është përfshirë në analizën financiare nga Komisioni.

91. Nga shqyrtimi i aktit nr. ***, datë 30.3.2023 për ekspertim grafik nënshkrimesh, vërehet se:

- Objekt ekspertimi është vetëm dokumenti “akt shitblerjeje nr. ***, datë 2.5.1996, i noteres G. Ll. Sh.”.

- Sipas aktekspertimit, kërkohet të përcaktohet nëse firma në emër të shtetases Izabela B. (Radovani) është shkruar apo jo prej saj.

- Dokumenti objekt ekspertimi është paraqitur në fotokopje bardhë e zi dhe eksperti është shprehur se në këtë gjendje që paraqitet dokumenti e ka të pamundur të përcaktojë se me çfarë lloj mjeti shkruet apo tonalitetin e ngjyrës së bojës është dorëshkruar firma objekt ekspertimi.

- Në cilësinë e modeleve të krahasimit janë paraqitur nënshkrime në emër të shtetases Izabela B. (Radovani) në 6 dokumente të nënshkruara prej saj, ndër të cilat edhe akt shitblerje pasurie të paluajtshme apartament banimi me nr. ***, datë 25.5.1997, lidhur para noteres G. Ll. Sh., në të cilën subjekti është në cilësinë e palës shitëse.

- Në lidhje me modelet e krahasimit eksperti është shprehur se: “Nga ekzaminimi krahasues që bëjmë midis karakteristikave shkrimore të vetë nënshkrimeve model krahasuese, më rezulton se e pasqyrojnë stereotipin dinamik mjaftueshëm të të gjitha modelet. Pra, të gjitha modelet krahasuese të nënshkrimit në emër të Izabela B. (Radovani) janë shkruar nga i njëjti person”.

- Në përfundim, eksperti ka konkluduar se “Nënshkrimi objekt ekspertimi (firma) në emër të ‘blerësja Izabela B. (Radovani)’ që gjendet te dokumenti objekt ekspertimi ‘akt shitblerje pasurie të paluajtshme apartament banimi’ me nr. ***, datë 2.5.1996, kryer në Shkodër para

noteres. G. Ll. Sh., nuk duhet të jetë shkruar nga Izabela B. (Radovani), krahasuar me modelet e nënshkrimit në emër të kësaj shtetaseje”, duke shënuar se për të arritur në një konkluzion kategorik, duhet t’i vendoset në dispozicion dokumenti objekt ekspertimi në origjinal.

92. Nga analiza e parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, vërehet se:

- Subjekti kundërshton vetëm nënshkrimin në kontratën e blerjes së apartamentit nr. ***, datë 2.5.1996, pra nuk kundërshton faktin që e ka shitur këtë pasuri me kontratë të datës 28.5.1997, të cilën e ka vënë në dispozicion të ekspertit si model krahasues të nënshkrimit të saj së bashku me disa akte të tjera të nënshkruara prej saj.

- Sa i takon adresave të banimit dha të njëjtat sqarime si në përgjigje të pyetësorit nr. 2, por nuk vërtetoi me dokumente shkresore të gjitha adresat e gjendjes civile dhe adresat e banimit, sikurse i është kërkuar nga Komisioni.

- Sa i takon argumenteve për të kundërshtuar barrën e provës, Komisioni çmon se nuk qëndrojnë për arsyet si vijojnë:

i) Pretendimet se në kontratën e blerjes subjekti nuk është identifikuar me gjeneralitete të plota dhe me mjet identifikimi nuk janë bindëse, pasi subjekti me të njëjtat gjeneralitete dhe pa mjet identifikimi ka nënshkruar edhe kontratën e shitjes së kësaj pasurie, tashmë të pranuar nga vetë ajo, ndërkohë që sipas aktekspertimit, *të gjitha modelet krahasuese të nënshkrimit në emër të shtetasës Izabela B. (Radovani) janë shkruar nga i njëjti person.*

ii) Pretendimi se nuk e ka nënshkruar kontratën e blerjes pasi në datën e blerjes në maj 1996 kishte mbiemrin B. dhe se mbiemrin Radovani e ka marrë me lidhjen e martesës datë 24.10.1996, nuk është bindës për sa kohë subjekti ka përdorur mbiemrin B. dhe pas lidhjes së martesës, siç rezulton në kontratën e shitjes nr. ***, datë 7.6.1997.

iii) Argumenti sipas të cilit nuk rezulton që subjekti të ketë lidhur kontratë energjie në adresën e kësaj pasurie, nuk mbart asnjë peshë për sa kohë periudha nga blerja te shitja e pasurisë është e shkurtër.

iv) Argumenti se adresa e kësaj pasurie nuk përputhet me adresën zyrtare të vendbanimit aktual të subjektit nuk mbart asnjë peshë në vetvete për sa kohë subjekti nuk paraqiti dokument për të vërtetuar të gjitha adresat e gjendjes civile të kërkuar nga Komisioni. Për më tepër, u vërtetua që subjekti ka qenë e pavërtetë dhe jokoherente në deklaratimet e saj lidhur me adresat e banimit.

v) Pretendimi i subjektit se ka vërtetuar shkencërisht që kontrata e shitjes së pasurisë nr. ***, datë 2.5.1996 nuk ka lidhje me të, nuk qëndron, pasi konkluzioni i ekspertit nuk është kategorik. Gjithashtu, nga analizimi i aktekspertimit grafik, ajo çfarë ka vlerë për Komisionin është fakti që eksperti ka konkluduar se akt shitblerja e pasurisë të paluajtshme apartament banimi me nr. ***, datë 28.5.1997, kryer në Shkodër para noteres G. Ll. Sh., është nënshkruar nga shtetasja Izabela B. (Radovani), fakt të cilin subjekti gjatë procesit administrativ e ka mohuar. Për më tepër, vetë subjekti e ka vendosur këtë kontratë si model krahasues në dispozicion të ekspertit duke pranuar kështu në mënyrë indirekte që është nënshkruar nga ana e saj. Komisioni çmon të theksojë se në këtë rast zë vend parimi thelbësor në të drejtën civile “*nemo dat quod non habet*”, askush nuk mund t’i tjetërsojë tjetrit një të drejtë, të cilën nuk e gëzon as vetë e, për rrjedhojë, konkludohet se përderisa subjekti e ka shitur këtë apartament atëherë edhe e ka blerë atë.

93. Për gjithë sa më sipër, pavarësisht se pasuria e blerë në vitin 1996 dhe shitur në vitin 1997 i përket një periudhe të hershme e para se subjekti të bëhej subjekt deklarues dhe moskryerja e deklarimeve në lidhje me këtë pasuri nuk ka ndonjë pasojë direkte në funksion të procesit të rivlerësimit, çmohet se subjekti i rivlerësimit dështoi të argumentojë bindshëm se nuk ka lidhje me këtë pasuri, ndërkohë që vërehet se, pasi ka marrë dijeni në lidhje me këtë pasuri pas pyetjes në ILDKPKI në vitin 2021 e deri në momentin e njohjes me rezultatet e hetimit, nuk ka ndërmarrë asnjë hap për të vërtetuar këtë fakt. Po kështu, në mënyrë të pakuptueshme, pas

njohjes me barrën e provës, subjekti ka kërkuar vetëm ekspertimin e nënshkrimit në kontratën e blerjes së pasurisë të vitit 1996, ku ajo figuron në cilësinë e palës blerëse, dhe jo të kontratës së shitjes së vitit 1997, ku ajo është në cilësinë e palës shitëse, duke thelluar edhe më shumë dyshimet në lidhje me pasurinë objekt verifikimi. Në referim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, kjo sjellje e përsëritur e subjektit të rivlerësimit me deklarime që nuk përkojnë me realitetin, deklarime kontradiktore dhe jokoherente, është marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor dhe përfundimtar të çështjes në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

94. Në deklaratën *Vetting*, në rubrikën e adresës sipas gjendjes civile, subjekti ka deklaruar adresën: Rajoni nr. ***, lagjja “****”, rruga “****”, p. nr. ***, Shkodër, ndërsa në certifikatën personale, rezulton adresa e banimit “Shkodër, ****”. Me kërkesë të Komisionit subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se adresa në gjendjen civile dhe e deklaruar nga ana e saj sot është rruga “****”, ndërtesa. ***, hyrja ***, apartamenti ***, kodi postar *** Shkodër, e cila përfaqëson adresën e gjendjes civile dhe atë të banimit që pas vitit 1999, duke shpjeguar se Bashkia Shkodër³⁹ ka hequr emërtimet e lagjeve dhe sot figurojnë vetëm emërtimi i rrugëve dhe banesat i ka ndarë në dy krahë *** dhe ***.

95. Bashkëshorti i subjektit K. R., në deklaratën *Vetting*, në rubrikën të dhëna konfidenciale ka deklaruar: *Pranë BKT-së sh.a. është çelur llogari depozitimesh në emrin K. R. për efekt pune (derdhje sigurime shoq, kontribute etj.)*. Por, nuk rezulton të ketë paraqitur ndonjë dokumentacion në lidhje me llogarinë e depozitimeve në BKT. ILDKPKI-ja ka konstatuar se BKT-ja nuk konfirmon llogari ne emër të shtetasit K. R., ndërsa BKT-ja⁴⁰ ka konfirmuar se shtetasi K. R. nuk ka pasur dhe nuk ka llogari pranë kësaj banke, por rezulton të jetë administrator dhe aksioner i subjektit K. R. PF me NIPT ****, klient i bankës.

96. Në pyetësonin nr. 2, iu kërkuar subjektit të vërtetojë me dokumentacion shkresor këtë llogari, periudhën e hapjes, lëvizjet në llogari dhe gjendjen aktuale, e cila paraqiti fotokopje të shkresës nr. *** prot., datë 7.11.2022, të BKT-së, dega Shkodër, sipas së cilës shtetasi K.R. PF, ka llogarinë bankare nr. ***, në lekë, si dhe ekstraktin e llogarisë. Me njoftimin e rezultateve të hetimit u kërkuar që subjekti të paraqesë dokumentin e mësipërm, origjinal ose të njëzuar me origjinalin, të cilat nuk i paraqiti në parashtrim, por në seancën dëgjimore paraqiti një konfirmim të lëshuar nga BKT-ja për gjendjen dhe transaksionet e kësaj llogarie të hapur si person fizik në emër të personit të lidhur për periudhën 2013 e në vijim, në të cilën konfirmohet se në të janë kryer transaksione të natyrës tregtare për pagesat e detyrimeve tatimore apo sigurimeve shoqërore si person fizik dhe, për rrjedhojë, Komisioni nuk konstatoi ndonjë problematikë në lidhje me këtë çështje.

97. Nga të dhënat e sistemit TIMS rezulton se subjekti ka udhëtuar jashtë shtetit me automjetet me targa: ***, ***, ***, ***, ***, ***. Subjekti ka dhënë shpjegimet e veta në lidhje me udhëtimet dhe pronarët e mjeteve, shpenzimet për të cilat janë përfshirë në shpenzimet e jetesës. Nuk ka pasur të dhëna apo dyshime sa i takon informacionit të marrë nga sistemi TIMS.

Analiza financiare për vitet 1996 - 2003 dhe 2004 – 2016

98. Bazuar në, dokumentacionin e administruar në dosje, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI, si dhe në përgjigje të pyetësorëve të dërguar gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën paraprake të treguesve financiarë lidhur me pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur, për çdo vit, për periudhën nga viti 1996 – 31.12.2003 dhe për vitet 2004 – 2016, nga ku duket se

³⁹ Shihni dokumentet në përgjigje të pyetësorit nr. 2, shkresë datë 9.11.2022 të Bashkisë Shkodër, me anë të së cilës informohet se adresa e kërkuar, referuar vërtetimit hipotekor, ndodhet në lagjen nr. ***, si më poshtë: “****” nd. ***, h. ***, ap. ***, Kodi Postar *** Shkodër. Në këtë shkesë është sqaruar se adresa është e përditësuar në Regjistrin Kombëtar të Adresave pranë Z.GJ.Civile, e cila përputhet me dokumentin hipotekor në emër të K. R.. Gjithashtu sqarohet se adresari i ri ka ndryshuar dhe nuk përcaktohen më me emërtesat e vjetra. “****” është emërtesë e vjetër pjesë në territorin ku përfshihet segmenti ***. “****” pjesë e territorit të Lagjes nr. *** sot, gjithashtu është emërtesë e vjetër dhe nuk ka lidhje me adresarin e ri.

⁴⁰ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 8.6.2021, të BKT-së në dosjen e Komisionit.

subjekti ka rezultuar në pamundësi financiare si vijon: (i) për periudhën 1996 – 31.12.2003 balanca negative e fondeve (-380.700 lekë); (ii) për vitin 2008 – balanca negative e fondeve (-1.534.384 lekë); (iii) për vitin 2010 – balanca negative e fondeve (-12.318 lekë); (iv) për vitin 2011 – balanca negative e fondeve (-228.121 lekë). Pra, ka një total balance negative në shumën – 2.155.523 lekë. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e këtij konstatimi. Në analizë të çdo pretendimi dhe dokumenti që subjekti ka paraqitur në parashtrimet e veta, trajtuar në mënyrë të detajuar në këtë vendim, në përfundim të procesit Komisioni çmon se, subjekti i rivlerësimit nuk ka vërtetuar të kundërtën e barrës së provës lidhur me analizën financiare, për shkak se ajo dhe personi i lidhur nuk kanë pasur mjaftueshëm të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive, si dhe, kryerjen e shpenzimeve të tjera.

TABELA PËRMBLEDHËSE E ANALIZËS FINANCIARE PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT IZABELA RADOVANI

	1996-2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
A) PASURI	5,817,744	338,713	527,834	-16,323	899,221	3,153,140	12,740	1,087,812	1,139,293	942,747	579,380	-337,121	867,257	-132,537
Apartament me sipërfaqe 76 m ² , H. ***, K. ***, ndodhur në rr. *** Shkodër, në vlerën 1.300.000 lekë në datë 3.8.1996 nga shtetasi D. P.	1,300,000													
Shtëpi banimi, apartament, me sip. 76 m ² , nr.Pasurije ***, ZK ***, adresa lgj. ***, rruga ***, pall. Nr.***, Shkoder. Paguar vlera 1,800.000 lekë në dt.15.12.1998.	1,800,000													
Autovetura tipit Daimler Chrysler me targa ***.						425,774								
Njësi dyqan me sip. 34,5 m ² , e ndodhur ne Shkodër.						3,000,000						500,000		
Ndryshim likuiditeti	2,717,744	338,713	527,834	-16,323	899,221	-272,634	12,740	1,087,812	1,139,293	942,747	579,380	-837,121	867,257	-132,537
B) DETYRIME	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
C) PASURI NETO (A-B)	5,817,744	338,713	527,834	-16,323	899,221	3,153,140	12,740	1,087,812	1,139,293	942,747	579,380	-337,121	867,257	-132,537
D) TË ARDHURA	7,983,870	2,183,661	2,902,631	3,001,516	2,738,257	2,208,125	2,322,767	1,634,065	1,722,494	1,940,902	2,004,882	2,212,185	2,176,222	2,639,107
Të ardhura nga paga e SR	2,680,615	539,832	729,857	903,676	904,278	977,740	1,022,075	1,116,902	1,160,142	1,158,205	1,206,266	1,450,971	1,460,592	1,340,579
Të ardhura nga paga e bashkëshortit të SR	498,278	115,722	128,294	139,680	138,446	144,240	160,368	167,742	174,456	181,428	189,716	162,690	224,400	332,350
Të ardhura nga ushtrimi i aktivitetit të bashkëshortit të SR (fitimi neto)	4,711,682	1,424,000	1,908,160	1,958,160	1,442,480	1,086,145	900,000	180,000	217,927	328,450	321,820	309,619	304,920	916,388
Të ardhura nga interesat e depozitës me afat në Raiffeisen Bank/Banka e Kursime	93,296	104,107	136,320		253,053		240,324	169,421	169,969	169,938	158,831	132,300	120,477	5,932
Të ardhura nga interesat e depozitës me afat në Tirana Bank	-									102,881	128,250	156,605	59,353	43,858
Të ardhura nga punësimi i personit të lidhur J.R													6,480	
E) SHPENZIME	2,546,826	394,456	438,228	458,276	693,498	589,369	546,480	558,571	811,322	612,752	727,701	1,061,477	1,131,828	1,608,286
Shpenzime minimale jetike	2,228,826	375,456	438,228	438,228	546,480	546,480	546,480	546,480	546,480	564,096	564,096	879,992	897,104	940,368
Shpenzime shkollimi për personin e lidhur J.R										28,080	67,600	65,700	41,220	25,000
Shpenzime shkollimi për personin e lidhur G.R											26,600	67,380	70,700	319,820
Shpenzime qiraje/konvikti në Tiranë për personat e lidhur													25,000	124,000
Shpenzime mobilimi	318,000	19,000												
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit				20,048	147,018	42,889	-	12,091	264,842	20,576	69,405	48,405	97,804	199,098
Balancë e fondeve (D-C-E)	-380,700	1,450,492	1,936,569	2,559,564	1,145,538	-1,534,384	1,763,547	-12,318	-228,121	385,404	697,801	1,487,829	177,137	1,163,358

Metodologjia e analizës së treguesve financiarë

99. Analiza financiare është kryer për të verifikuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga këto burime. Nga Komisioni, për arritjen e rezultateve financiare të reflektuara në tabelat përkatëse, për periudhën referuese, u morën në analizë të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, dokumentacioni financiar pjesë e dosjes përkatëse të ILDKPKI-së, përgjigjet e subjektit në pyetësorët e dërguar gjatë hetimit administrativ, si dhe të dhëna nga institucione shtetërore dhe subjekte të tjera juridike. Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për kategoritë pasuri, detyrime, të ardhura dhe shpenzime për subjektin dhe personat e tij të lidhur për periudhat 1996 – 2003 dhe 2004 – 2016, mbështetur në dokumentacionin justifikues ligjor, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit për të ardhurat, shpenzimet, pasuritë, detyrime, si dhe analizën e burimit të deklaruar të të ardhurave të përdorura për krijimin e pasurive (të paluajtshme, të luajtshme dhe likuiditete), dhe mbulimin e shpenzimeve të ndryshme.

Pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme

- Pasuria, apartament me sip. 76 m² në Shkodër, blerë në vitin 1996 prej shtetasit D. P. është pasqyruar në analizën financiare si investim i kryer në shumën 1.300.000 lekë dhe i shitur në vitin 1997, e ardhura prej 1.350.000 lekësh e përfituar nga shitja e kësaj pasurie në datën 7.6.1997, nuk është konsideruar e ligjshme për shkaqe të përmendura në këto rezultate.
- Pasuria, apartament më sip. 76 m² në Shkodër, i blerë në vitin 1998 prej shtetasve G. është pasqyruar në analizën financiare si investim i kryer në shumën 1.800.000 lekë.
- Pasuria, njësi/dyqan në Shkodër, është pasqyruar në analizën financiare si i paguar në vitin 2008 në vlerën 3.000.000 lekë dhe në vitin 2014 në vlerën 500.000 lekë.
- Pasuria, apartament me sip. 70 m² në Shkodër, e përfituar me anë të shitblerjes prej shtetasve G. në shumën 220.000 lekë dhe më pas e shitur në shumën 1.050.000 lekë shtetasit N., nuk është pasqyruar në analizën financiare.
- Pasuria e llojit automjet tip “Daimler Chrysler” blerë nga subjekti në vitin 2008 është pasqyruar në analizën financiare në vlerën 1.000 euro dhe 302.591 lekë.
- Kursimet *cash* në banesë apo për shtesat/pakësimet vjetore, janë konsideruar duke analizuar deklaratimet periodike vjetore dhe dokumentacionin ligjor justifikues të burimit të deklaruar të krijimit dhe destinacionin e tyre.

Të ardhurat

- Të ardhurat nga pagat e subjektit dhe personave të lidhur janë pasqyruar sipas dokumentacionit të paraqitur dhe nga lëvizjet e llogarive bankare të mbërritura nga institucionet financiare.
- Të ardhurat e personit të lidhur nga ushtrimi i aktivitetit si noter janë pasqyruar sipas përlllogaritjes nga dosjet fizike të regjistrimit noterial të akteve dhe dokumentacionit të paraqitur nga DRT-ja Shkodër.
- Të ardhurat nga interesat e depozitave janë pasqyruar sipas dokumentacionit të paraqitur dhe nga lëvizjet e llogarive bankare të mbërritura nga institucionet financiare.
- Të ardhurat nga përfitimi i të persektuarve janë konsideruar 0 (zero) për sa kohë subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për to.

Shpenzimet

- Shpenzimet e arsimit/qirasë të të dy fëmijëve të subjektit, janë pasqyruar sipas të dhënave të deklaruara/dokumentuara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ.

- Shpenzimet për udhëtimet jashtë vendit (shpenzime transporti dhe qëndrimi) janë llogaritur, mbi bazë të dokumentacionit ligjor të disponuar, deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe referuar metodologjisë së aplikuar nga Kolegji [vendim nr. 11 (JR), datë 22.5.2019].

- Shpenzime mobili/arredimi janë përlllogaritur sipas vetëdeklarimit të subjektit dhe përcaktimeve të dhëna në rezultatet e hetimit administrativ.

- Shpenzimet minimale jetike për vitet 1991 – 1999 janë përlllogaritur në vlerën 66% të të ardhurave të realizuara për çdo vit ndërsa për periudhën 2000 – 2016 sipas të dhënave të marra nga ILDKPKI-ja.

100. Në përfundim të procesit të rivlerësimit të pasurisë, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të kreut IV të ligjit nr. 84/2016, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit Izabela Radovani: (i) ka kryer deklarime kontradiktore, të pasakta dhe që vijnë në kundërshtim me ligjin, sipas parashikimit të germës “a” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016; (ii) nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet sipas germës “b” të pikës 5; (iii) ka kryer deklarim të rremë sipas germës “c” të pikës 5; (iv) është gjendur në kushtet e konfliktit të interesit sipas germës “d” të pikës 5. Për rrjedhojë, ka kryer deklarim të pamjaftueshëm në lidhje me kriterin pasuror që sipas nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016, përbën shkak për shkarkimin nga detyra.

Kontrolli i figurës

101. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 30.10.2017 mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Izabela Ç. Radovani (B.), i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 9.6.2021, të KDZH-së, nga ku rezulton se: (i) formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar. Në konkluzion të këtij raporti, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Izabela Ç. Radovani (B.).

102. Pas kërkimeve gjatë hetimit, ka rezultuar se nuk disponohen të dhëna të përditësuara për subjektin Izabela Radovani. SPAK-u⁴¹ ka informuar se në emër të shtetases Izabela Ç. Radovani nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal. Ndaj shtetases Izabela Ç. Radovani kanë ardhur materiale kallëzuese nga shtetasit Gj. L. dhe B. D., të cilët janë dërguar për vlerësim në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Nga aktet e përcjella nga Prokuroria e Përgjithshme⁴², rezulton se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendosur mosfillimin e procedimeve penale të këtyre kallëzimeve.

103. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni nuk evidentoi fakte dhe rrethana që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit, të cilat do të ndryshonin konstatimin fillestar të Grupit të Punës të DSIK-së, duke çmuar se subjekti i rivlerësimit Izabela Radovani, është i përshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës, për shkak se ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

⁴¹ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 7.6.2021, të SPAK-ut, në dosjen e Komisionit.

⁴² Shihni shkresën nr. *** prot., datë 8.7.2021, të Prokurorisë së Përgjithshme, në dosjen e Komisionit.

Vlerësimi i aftësive profesionale

104. Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit Izabela Radovani, bazuar në: (i) raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me nr. *** prot., datë 26.4.2022, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 29.4.2022; (ii) informacionin e marrë nga burime të ligjshme; (iii) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Raporti për analizimin e aftësive profesionale kryer nga KLGJ-ja është bazuar në:

105. Analiza e kryer nga KLGJ-ja në vlerësimin e aftësive profesionale, është bazuar në: (i) formularin e vetëdeklarimit; (ii) tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe në të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë atë; (iii) pesë dosjet gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iv) të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së, sipas të cilave gjatë periudhës së rivlerësimit të gjyqtarës nuk ka pasur asnjë procedim disiplinor dhe nuk është marrë asnjë masë disiplinore, ndërsa rezultojnë se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit për gjyqtaren Izabela Radovani, janë paraqitur 9 ankesa nga të cilat 6 janë arkivuar, 2 ankesa janë verifikuar për mosrespektim formal ligji dhe janë dërguar pranë ILD-së, për të cilat në përfundim të hetimit administrativ Komisioni nuk konstatoi problematika, ndërsa një ankesë e verifikuar për zvarritje i është regjistruar gjyqtarës për efekt vlerësimi profesional dhe etik, për të cilën Komisioni kreu verifikimin e saj, trajtuar gjerësisht në paragrafët 128-133.

106. Pasi ka analizuar të dhënat si më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 96/2016 ka vlerësuar subjektin e rivlerësimit si vijon:

106.1. Aftësitë profesionale

a. *Njohuritë ligjore:* shtetasja Izabela Radovani ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Ajo identifikon normën ligjore, kualifikon drejt marrëdhënien juridiko-civile, zgjidh drejt mosmarrëveshjet objekt gjykimi.

b. *Arsyetimi ligjor:* shtetasja Izabela Radovani ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare plotësojnë elementet e përcaktuara nga ligji. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Dispozitivi i vendimit është i plotë dhe i qartë. Ajo i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme.

106.2. Aftësitë organizative

a. *Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë:* subjekti i rivlerësimit Izabela Radovani në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016 ka kryer detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në seksionin civil të përgjithshëm e atë familjar. Në formularin e vetëdeklarimit, rendimenti i përfundimit të çështjeve është 102%. Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, rezultojnë se ngarkesa e saj sasiore ka qenë mbi standardin minimal. Aftësia e saj për gjykimin e shpejtë të çështjeve është bërë edhe objekt ankesash. Konkretisht, 3 ankesa janë verifikuar për zvarritje gjykimi dhe pas verifikimit, dy janë arkivuar pasi nuk rezultuan shkelje, një ankesë e vitit 2016 i është regjistruar gjyqtarës për efekt vlerësimi profesional dhe etik. Në analizë të të dhënave konstatohet se subjekti i rivlerësimit Izabela Radovani, ndonëse ka pasur ngarkesë të lartë sasiore, e respekton kohën në gjykim si element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor dhe i ka gjykuar çështjet brenda afateve standarde të ligjore të gjyqimit. Gjithashtu, ajo i ka kushtuar rëndësi arsyetimit të vendimeve gjyqësore duke respektuar afatet ligjore.

b. *Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore:* subjekti i rivlerësimit Izabela Radovani ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje nëpërmjet vendimit

për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Orari i fillimit dhe i mbarimit të seancës gjyqësore ka rezultuar se është respektuar në rastet e vëzhguara, me përjashtim të seancës së dosjes 5, filluar me 38' vonesë. Gjatë gjykimit, gjyqtarja Izabela Radovani zhvillon dhe dokumenton procedurën e gjykimit, orienton drejt debatit dhe hetimit gjyqësor, marrjen e provave, kërkimet dhe prapësimet e palëve, diskutimin përfundimtar deri në dhënien e vendimit përfundimtar.

c. *Aftësia për të administruar dosjet*: nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, përgjithësisht, nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të.

106.3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a. *Etika në punë*: për gjyqtaren Izabela Radovani është paraqitur 1 ankesë e vitit 2016, e cila pas verifikimit për mosrespektim formal ligji dhe shkelje etike, është arkivuar pasi nuk rezultuan shkelje. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative lidhur me etikën nga subjekti i rivlerësimit.

b. *Integriteti*: nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Izabela Radovani dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c. *Paanësia*: nga 3 dokumentet ligjore dhe nga 5 dosjet nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Izabela Radovani. Nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve, nuk janë konstatuar çështje të barazisë gjinore apo të pakicave, si dhe nuk është konstatuar as përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

106.4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a. *Aftësitë e komunikimit*: në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja Izabela Radovani komunikon me etikë. Ajo ka aftësi komunikuese, si gjatë veprimtarisë përgatitore e asaj gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

b. *Aftësia për të bashkëpunuar*: nuk ka pasur dështim të seancave të planifikuara, apo vonesa për fillimin e seancave gjyqësore, për shkak të mungesës së bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

c. *Gatishmëria për t'u angazhuar*: shtetasja Izabela Radovani i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Ajo ka marrë pjesë në 15 trajnime të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës. Lidhur me trajnimet e tjera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, subjekti deklaroi se nuk ka kryer trajnime të tilla.

Informacioni i marrë nga burime të ligjshme, ku si të tilla janë konsideruar:

107. Tri vendimet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë çështjet e shortuara sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, nga analiza e të cilave rezultuan të njëjtat gjetje të konstatuara edhe nga KLP-ja në raportin e saj.

108. Informacioni i marrë nga 16 denoncime të paraqitura nga publiku sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, në 8⁴³ prej të cilave pretendimet e denoncuesve nuk provoheshin ose dhe lidheshin me vendimmarrje të padrejtë të subjektit të rivlerësimit, vlerësimi i të cilave në zbatim të nenit të nenit 72/4 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e

⁴³ Shihni denoncim nr. *** prot., datë 13.1.2021; denoncim nr. *** prot., datë 3.3.2020; denoncim nr. *** prot., datë 25.1.2021; denoncim nr. *** prot., datë 17.5.2022; denoncim nr. *** prot., datë 15.3.2019; denoncim nr. *** prot., datë 17.5.2022; denoncim nr. *** prot., datë 16.12.2020, në dosjen e Komisionit.

Shqipërisë”, është jashtë tagrit të vlerësimit të Komisionit. Ndërsa për një denoncim⁴⁴ iu kërkuan sqarime subjektit gjatë procesit të hetimit administrativ dhe pas shqyrtimit të tyre u konstatua se pretendimet e denoncuesit nuk qëndrojnë. Në 7 denoncime Komisioni kreu hetim të thelluar, të cilat iu bënë me dije subjektit të rivlerësimit me njoftimin e tyre.

Denoncim nga *-ja⁴⁵**

109. Ndaj subjektit të rivlerësimit, ngrihen pretendime për njëanshmëri, për një çështje e cila është në gjykim nga gjyqtarja Izabela Radovani, me palë paditëse G. Y. etj., i paditur *** me objekt marrëdhënien e punës, pasi: (a) në seancën e datës 18.9.2017 ka vendosur mbylljen e hetimit gjyqësor dhe kalimin në diskutimet përfundimtare. Në datën 23.10.2017 paditësi ka paraqitur kërkesë për dëgjimin e CD audio dhe subjekti i rivlerësimit e ka pranuar në cilësinë e provës, si dhe ka pranuar kërkesën për ndryshimin e objektit të padisë dhe shtimin e saj në kundërshtim me nenin 185 të Kodit të Procedurës Civile; (b) në seancën e datës 23.10.2017 ka qenë i pranishëm shtetasi A. Y. (gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër) duke këshilluar vëllain e tij G. Y. dhe se nga ana e palës së paditur është kërkuar që shtetasi A. Y. të mos vazhdonte të ndërhynte në këtë proces dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka reagu; (c) gjithashtu, denoncuesi pretendon se Kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me shkresën nr. *** prot., datë 22.9.2017, drejtuar ***-së, ka theksuar se paditë e ngritura ishin të shoqëruara me anomali si: paditë ishin të njëjta ose thuaj se të njëjta, buronin nga një marrëdhënie e vetme mes ***-së dhe shtetasit G. Y., ka pasur dyshime për ndërhyrje të vëllait z. G. Y., A. Y., i cili është gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, pasi ka konstatuar pjesëmarrjen e tij në disa seanca gjyqësore si dëgjues, etj., dhe se, në lidhje me këto shqetësime është në proces verifikimi.

110. Gjatë hetimit administrativ, me kërkesë të Komisionit subjekti dha sqarime shoqëruar me dokumentacion⁴⁶ dhe CD audio, mbi pretendimet e ngritura që kanë të bëjnë me çështjen gjyqësore për të cilën subjekti i rivlerësimit me vendimin nr. ***, datë 9.2.2018, me palë paditëse G. Y. etj.; palë e paditur ***; person i tretë Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi; me objekt “konstatimi i zgjidhjes së menjëhershme pa shkaqe të arsyeshme (abuzive)”, etj., ka vendosur: pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë, konstatimin e faktit të diskriminimit..., detyrimin të dëmshpërblejë paditësit për dëmin jopasuror... në vlerën 4.507.668 lekë.

111. Pasi u analizuan deklaratimet e subjektit dhe të gjitha të dhënat e dokumenteve shkresore të administruara vërehet se, pretendimet e denoncuesit në pikat (a) dhe (b) nuk u vërtetuan, shtjelluar më gjerësisht në rezultatet e hetimit administrativ. Në lidhje me shkresën e Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër datë 22.9.2017, subjekti deklaroi se ka marrë dijeni

⁴⁴ Shihni denoncim nr. *** prot., datë 14.6.2019 në dosjen e Komisionit dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

⁴⁵ Shihni denoncim nr. *** port., datë 24.11.2017 dhe shkresë nr. *** prot., datë 22.11.2022 të MD ankesa e OST përcjellë IKDL-së, në dosjen e Komisionit.

⁴⁶ Shihni dokumentet e paraqitura në përgjigje të pyetësorit nr. 2: (i) kërkesë datë 4.11.2022 drejtuar kryesekretarisë dhe arkivës së gjykatës për pajisje me vendimet gjyqësore të dhëna si gjyqtare nr. *** datë 27.12.2018, nr. *** datë 13.5.2019, nr. *** datë 9.2.2018 dhe kthim përgjigjeje të gjykatës Shkodër nr. *** prot. datë 8.11.2022 sipas së cilës dosja civile ndodhet në gjykatën e Apelit Shkodër; (ii) vendim nr. ***, datë 9.2.2018, ndaj të cilit është bërë ankim nga pala paditëse dhe dosja ndodhet pranë gjykatës së apelit; (iii) kërkesën e subjektit datë 7.11.2022 drejtuar kryetarit të gjykatës, kryesekretares dhe arkivës së gjykatës për pajisjen me shkresën nr. *** prot., datë 22.9.2017, të Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; (iv) kthim përgjigjeje bashkëngjitur shkresa nr. *** prot., datë 22.9.2017, të Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; (v) kthim përgjigjeje të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, nr. *** prot., datë 8.11.2022; (vi) vendim nr. *** prot., datë 11.11.2022 të ILD-së, sipas të cilit në lidhje me ankesën e OST ndaj disa gjyqtarëve të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Shkodër, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit dhe pas verifikimit të praktikës ka vendosur arkivimin; (vii) shkresë nr. *** prot., datë 15.11.2022, nga Gjykata e Apelit Shkodër sipas së cilës dosja është regjistruar në Gjykatën e Apelit dhe pret radhën për gjykim; dosjen gjyqësore nr. *** vendimi, datë 9.2.2018, nga Gjykata e Apelit Shkodër; (viii) pritimi të procesverbaleve të seancave gjyqësore (jo pjesë të dosjes të cilat janë të pafirmosura); CD audio të seancave datë 18.9.2017 dhe 23.10.2017, CD e cilat nuk hapet.

për këtë shkresë nga Komisioni. Nga ana tjetër deklaroi se e ka komunikuar këtë shqetësim me Kryetarin, pra deklaratimet nuk duken në harmoni me njëra-tjetrën. Po kështu, në dosjen gjyqësore⁴⁷ nuk gjenden procesverbalet e datave 25.1.2018, 1.2.2018, 9.2.2018. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të japë sqarime e dokumente në lidhje me këto konstatime.

112. Në parashtrimet e saj dhe dokumentet bashkëlidhur, përgjithësisht subjekti i referohet faktit që nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë është verifikuar kjo ankesë në respektim të ligjit nr. 96/2016 e cila është arkivuar me vendimin “Për arkivimin pas verifikimit të praktikës së përcjellë nga ish-KLD-ja lidhur me ankesat e paraqitura nga ***-ja me nr. *** prot., datë 11.11.2022, i ILD-së. Siç vërehet, subjekti nuk ka dhënë asnjë sqarim në lidhje me deklaratimin kontradiktor në lidhje me shkresën e Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër datë 22.9.2017. Sa i takon mungesës së procesverbaleve, subjekti pretendon se i ka vënë në dispozicion gjatë hetimit edhe procesverbalet e seancave gjyqësore të datave 25.1.2018, 1.2.2018 dhe 9.2.2018, pretendim i cili nuk qëndron pasi subjekti ka paraqitur printime të procesverbaleve të panëshkruara nga sekretarja dhe subjekti, të cilat nuk janë pjesë e dosjes gjyqësore. Subjekti sqaroi se, çështja është ankimuar dhe nuk është gjykuar ende nga Gjykata e Apelit.

Denoncim nga Spitali Rajonal Shkodër⁴⁸

113. Ky institucion ka paraqitur pranë Komisionit ankim ndaj vendimit nr. ***, datë 28.3.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër drejtuar Gjykatës së Apelit Shkodër dhe për dijeni Komisionit. Nga përmbajtja e ankimit denoncuesi ngre pretendime në lidhje me vendimmarrjen, si dhe shkelje të paanshmërisë pasi ka lejuar pjesëmarrjen në seancë gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër A. Y., vëllai i avokatit së palës paditëse, si dhe me lidhje familjare me palën paditëse, që sipas denoncuesit rezultoi e provuar nga pamjet filmike dhe regjistrimet audio të seancës gjyqësore datë 24.1.2019, si dhe pretendime sa i takon vendimmarrjes.

114. Gjatë procesit të hetimit administrativ, me kërkesë të Komisionit subjekti dha sqarime shoqëruar me dokumentacion⁴⁹ dhe CD audio, mbi pretendimet që kanë të bëjnë me çështjen gjyqësore me palë paditëse A. Y. dhe palë e paditur Spitali Rajonal Shkodër, me objekt detyrim e palës së paditur për të paguar pagën e prapambetur që nga data 19.10.2018, etj., ka vendosur: pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë; detyrim e palës së paditur për të paguar paditësit pagën e prapambetur duke filluar nga data 19.10.2018 deri në momentin kur paditësit t’i sigurohet mbrojtja nga diskriminimi.

115. Në analizë të deklaratimeve dhe dokumenteve shkresore që subjekti paraqiti, në përfundim të hetimit administrativ u konstatua se pretendimet e denoncuesit nuk qëndrojnë, shtjelluar hollësisht në rezultatet e hetimit administrativ, por, procesverbalet e seancave gjyqësore, me

⁴⁷ Neni 118 i Kodit të Procedurës Civile: “Procesverbali është pjesë përbërëse e dosjes gjyqësore dhe ruhet për aq kohë sa edhe vetë dosja”.

⁴⁸ Shihni denoncimin nr. *** prot., datë 23.4.2019, në dosjen e Komisionit.

⁴⁹ Shihni dokumentet e paraqitura në përgjigje të pyetësorit nr. 2: (i) kërkesën e saj datë 16.11.2022, drejtuar punonjësit IT dhe kancelares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me anë të cilës ka kërkuar pamjet filmike të datës 24.1.2019 të sallës ***, nëse ekzistojnë; (ii) kthim përgjigjeje datë 17.11.2020 të specialistit IT, ku ka informuar se pamjet filmike ruhen për një periudhë 60-ditore përveç rastit kur kërkohet ruajtja nga palët për nevoja të gjykimit. Nga verifikimi nuk rezultoi të jenë ruajtur pamjet të datës 24.1.2019 dhe as kërkesë të palëve për ruajtjen e tyre; (iii) vendim nr. *** prot., datë 12.1.2022, të ILD-së për arkivimin e ankesës, sipas të cilit ankuesi ka paraqitur ankim ndaj vendimit nr. ***, datë 28.3.2019, të cilin ia ka drejtuar Gjykatës së Apelit Shkodër. Në këtë vendim është cituar se në aspektin procedural vendimi nr. ***, datë 28.3.2019, i gjykatës, respekton të gjitha dispozitat e Kodit të Procedurës Civile. Në aspektin substancial, pretendimet e ankuesit lidhen me vendimmarrjen nga ana e gjykatës, trajtimi i pretendimeve për zbatim të gabuar apo mosrespektim të legjisllacionit procedural ose material gjatë shqyrtimit gjyqësor, është kompetence e gjykatave më të larta; (iv) dosjen gjyqësore me palë paditëse A. Y. dhe palë e paditur SRSR nga Gjykata e Apelit Shkodër; (v) CD të regjistrimit audio të seancës datë 24.1.2019.

përfashtim të procesverbalit datë 11.3.2019, nuk janë të nënshkruara nga subjekti i rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit 118⁵⁰ të Kodit të Procedurës Civile. Me njoftimin e rezultateve të hetimit administrativ, iu kërkua subjektit të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim.

116. Në parashtrimet e saj, subjekti sqaroi se mungesa e nënshkrimit të magjistratit në procesverbalet e seancave gjyqësore mund të jetë vërejtur në disa raste, por ajo e ka praktikë pune që çdo seancë, përgatitore ose gjyqësore e zhvillon në sallë nëpërmjet sistemit audio, në këto kushte, seancat janë të gjitha të regjistruara. Sipas subjektit, neni 118 parashikon se: *“Nëse nuk është e mundur që procesverbali të mbahet nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv, ai mbahet duke bërë një përmbledhje të saktë me shtypshkrim apo dorëshkrim”*. Në këtë rast vlejné parashikimet e dispozitës mbi mënyrën e mbajtjes së procesverbalit. Subjekti pretendon se referuar praktikës gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, si dhe në respektim të nenit 77 të Kodit të Procedurës Civile, por edhe për shkak të ngarkesës në punë, nga ana e gjyqtarëve, kjo është lënë si “detyrë e sekretarit gjyqësor”, i cili dokumenton për të gjitha efektet, në rastet dhe në mënyrat e parashikuara nga ligji, veprimtari të mirëfillta të gjykatës, të palëve e pjesëmarrësve të tjerë në proces. Sekretari merr pjesë në të gjitha veprimet e gjykatës për të cilat duhet të mbahet procesverbal. Ndonëse mungesa e nënshkrimit të subjektit është e paqëllimtë dhe është korrigjuar në vijim, ky fakt nuk përbën pavlefshmëri të aktit në kuptim të nenit 119 të Kodit të Procedurës Civile. E në këtë këndvështrim, ky veprim i saj nuk passjellë asnjë pasojë nga ato që parashikojné nenet 466 dhe 467 të Kodit të Procedurës Civile, duke ritheksuar që në praktikën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër procesverbalet e seancave zakonisht nuk janë nënshkruar nga magjistrati, por vetëm nga sekretaria gjyqësore, sepse çdo seancë regjistrohet me sistemin audio. Subjekti sqaron se duke qenë se ky konstatim i Komisionit është përmendur disa herë në rezultatet e hetimit, ajo mban dhe shpreh të njëjtin qëndrim.

117. Në mbështetje të sqarimeve subjekti paraqiti vendimin nr. ***, datë 28.3.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër të administruar më parë nga Komisioni, si dhe procesverbalin e datës 11.3.2019 të nënshkruar vetëm nga subjekti.

118. Nga analizimi i parashtrimeve të subjektit, vërehet se subjekti e pranon se në disa raste të evidentuara edhe nga Komisioni, nuk i ka nënshkruar procesverbalet, por ky fakt ka qenë i paqëllimtë dhe është korrigjuar në vijim. Në vlerësim të Komisionit, argumenti se në praktikën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër kjo detyrë i është lënë sekretares, në radhë të parë nuk është i mbështetur në ndonjë provë, në radhë të dytë nënshkrimi i sekretares është një detyrim ligjor⁵¹, i cili nuk përjashton gjyqtarin nga nënshkrimi i procesverbalit. Nënshkrimi i procesverbalit të seancës gjyqësore nga sekretari dhe gjyqtari që kryeson seancën gjyqësore është një normë urdhëruese e ligjit procedural (neni 118 i Kodit të Procedurës Civile). Për pasojë, mosnënshkrimi i procesverbaleve të seancave në raste të përsëritura, konsiderohet një mangësi e aftësive organizative, parashikuar në nenin 74 të ligjit nr. 96/2016.

Denoncim nga shtetasi A. G.⁵²

⁵⁰ *“Nëse procesverbali mbahet në formë të përmbledhur me shtypshkrim apo dorëshkrim, ai nënshkruhet në fund të çdo faqeje nga sekretari dhe në fund të dokumentit nga kryetari i seancës, menjëherë pas seancës, dhe përfshihet në dosjen gjyqësore”*.

⁵¹ Shihni dhe vendimin nr. ***, datë 29.12.2022, të KLGJ-së, “Mbi miratimin e rregullave standarde për organigramën, përkrahimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm”, ku është pasqyruar qartë se: *Sekretari gjyqësor ushtron në veçanti funksionet e mëposhtme: a) mban procesverbalin e seancës gjyqësore në mënyrë elektronike, në përputhje me dispozitat procedurale civile dhe penale në fuqi; kur përdoren pajisje regjistrimi apo pajisje që kryejné funksione të ngjashme, sekretari garanton që regjistrimi ose riprodhimi është origjinal dhe i paprekur dhe është pjesë përbërëse e dosjes gjyqësore; merr masa që procesverbali i shënimeve të seancës së mbajtur me RDA, të nënshkruhet në fund të çdo faqeje nga sekretari gjyqësor dhe në fund të procesverbalit edhe nga kryetari i seancës, menjëherë pas përfundimit të seancës, duke u përfshirë në dosjen gjyqësore.*

⁵² Shihni denoncimin nr. *** prot., datë 7.2.2019, në dosjen e Komisionit.

119. Ky denoncues ngre pretendime në lidhje me vendimmarrjen dhe vlerësimin e provave nga ana e subjektit të rivlerësimit Izabela Radovani. Gjithashtu, pretendon se nga data 30.4.2018 deri më 27.12.2018 çështja është mbajtur në fazën e veprimeve përgatitore dhe në përfundim ka vendosur dhe pushimin e gjykimit, dhe se, është treguar e njëanshme pasi, sipas regjistrimit audio të datës 27.12.2018 dëgjohet avokati i palës së paditur që i drejtohet gjyqtarës “*nuk dimë si të intereson ty*”. Me kërkesë të Komisionit, subjekti dha sqarime shoqëruar me dokumentacion⁵³, mbi pretendimet që kanë të bëjnë me çështjen gjyqësore për të cilën subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 27.12.2018, ka vendosur pushimin e çështjes.

120. Pasi u shqyrtuan deklaratimet dhe dokumentet që subjekti paraqiti, në përfundim të hetimit administrativ u konstatua se pretendimet e denoncuesit nuk qëndrojnë, shtjelluar më gjerësisht në rezultatet e hetimit administrativ. Ndërkohë u konstatua se: (i) seanca përgatitore e datës 12.7.2018 është shtyrë për më 4.9.2018. Sipas procesverbalit të datës 4.9.2018 rezulton të jetë zhvilluar seancë gjyqësore dhe jo seancë përgatitore. Nga aktet në dosje nuk rezulton të jetë administruar urdhri i gjykatës për caktimin e seancës gjyqësore, sipas parashikimit të nenit 158/c të Kodit të Procedurës Civile⁵⁴; (ii) procesverbalet e seancave gjyqësore datë 28.6.2018 deri më 27.12.2018, nuk janë të nënshkruara nga subjekti i rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit 118⁵⁵ të Kodit të Procedurës Civile. Me njoftimin e rezultateve të hetimit administrativ, iu kërkua subjektit të japë sqarime në lidhje me këto konstatime.

121. Në parashtrimet e saj, subjekti sqaroi se nga hetimi i thelluar i kryer nga Komisioni, rezulton se pretendimet e denoncuesit nuk qëndrojnë dhe se ajo ka dhënë shpjegime lidhur me këtë çështje në pyetësonin nr. 2. Në lidhje me vendimin e dhënë për këtë çështje, denoncuesi A. G. e ka paraqitur apelim pranë Gjykatës së Apelit Shkodër dhe kjo çështje pret radhën të gjykohet nëse qëndrojnë apo jo shkeljet e ligjit material dhe procedural të pretenduara. Sa i takon konstatimit për mungesën e nënshkrimit në procesverbaleve të seancave gjyqësore, subjekti mban të njëjtin qëndrim si në rastet e tjera të evidentuara. Siç vërehet, subjekti nuk ka dhënë sqarime për konstatimet e kërkuara nga Komisioni në pikën (i) të cilat do të ndihmonin në një vlerësim sa më të drejtë të aftësive organizative, sipas parashikimeve të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016. Për rrjedhojë, edhe në këtë rast vërehen mangësi organizative të subjektit të rivlerësimit.

Denoncim nga shtetasi A. B.⁵⁶

122. Ky denoncues cili ngre pretendime për zvarritje të procesit, si dhe gjykim jo të drejtë ana e subjektit, pasi çështja ka zgjatur 10 muaj dhe në momentin e shpalljes së vendimit ka shpallur moskompetencën lëndore, me vendimin nr. ***, datë 20.12.2019. Gjyqtarja e ka metodë pune që pasi bën gjykim shpall moskompetencë, si dhe vepron me dy standarde. Me qëllim, verifikimin e pretendimeve për zvarritje të procesit gjyqësor, me kërkesë të Komisionit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër⁵⁷ vuri në dispozicion dosjen gjyqësore me nr. vendimi ***, datë 20.12.2019, CD audio dhe Gjykata e Lartë⁵⁸ vuri në dispozicion vendimin nr. ***, datë 20.5.2022. Nga shqyrtimi i akteve të dosjes gjyqësore, rezulton se:

- Nga data e regjistrimit të kërkesëpadisë 16.2.2019 dhe deri në datën e dhënies së vendimit datë 20.12.2019, çështja ka zgjatur 10 muaj e 4 ditë. Janë zhvilluar gjithsej 11 seanca 7 nga të cilat kanë qenë seanca përgatitore. I është dhënë fund hetimit gjyqësor dhe në seancën e

⁵³ Shihni dokumentet e paraqitura në përgjigje të pyetësonit nr. 2: shkresë nr. *** prot., datë 15.11.2022, nga Gjykata e Apelit Shkodër sipas së cilës dosja është regjistruar në Gjykatën e Apelit dhe pret radhën për gjykim; dosja gjyqësore me vendimin nr. ***, datë 27.12.2018, si dhe CD të regjistrimit audio të seancës datës 27.12.2018.

⁵⁴ : “1. Gjyqtari, menjëherë pasi kryen të gjitha veprimeve paraprake dhe/ose përgatitore të nevojshme, nxjerr urdhrin për caktimin e seancës gjyqësore, i cili u njoftohet palëve dhe personave të tretë”.

⁵⁵ “Nëse procesverbali mbahet në formë të përmbledhur me shtypshkrim apo dorëshkrim, ai nënshkruhet në fund të çdo faqeje nga sekretari dhe në fund të dokumentit nga kryetari i seancës, menjëherë pas seancës, dhe përfshihet në dosjen gjyqësore”.

⁵⁶ Shihni denoncimin nr. *** prot., datë 29.1.2020 në dosjen e Komisionit.

⁵⁷ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 17.11.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në dosjen e Komisionit.

⁵⁸ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 31.1.2023, të Gjykatës së Lartë, në dosjen e Komisionit.

shpalljes së vendimit subjekti ka shpallur moskompetencë lëndore. Procesverbalet e seancave nuk janë nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit.

- Me vendimin nr. ***, datë 20.12.2019, subjekti i rivlerësimit ka vendosur deklarin e moskompetencës lëndore dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Administrative Shkodër, duke arsyetuar se në rastin konkret mosmarrëveshja objekt gjykimi nuk rregullohet nga Kodi i Punës, por me ligj të posaçëm dhe sipas bindjes së gjykatës, kompetenca i përket gjykatës administrative. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, me vendimin datë 19.4.2022, ka vendosur t'i parashtrijë Gjykatës së Lartë zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës lëndore ndërmjet gjykatave. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 20.5.2022, "1. Rregullimin e kompetencës lëndore të gjykatave në mosmarrëveshje duke përcaktuar Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër si gjykatë kompetente. 2. Prishjen e vendimit nr. ***, datë 20.12.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër".

- Gjykata e Lartë, në vendimin nr. ***, datë 20.5.2022, në lidhje me këtë çështje, është shprehur ndër të tjera se: "Kolegji çmon se vendimi nr. ***, datë 20.12.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është marrë në interpretim jo të drejtë të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, ligjit nr. 7961/1995, i ndryshuar dhe ligjit nr. 10221/2010... Për sa i përket mënyrës se si caktohet gjyqtari natyral i çështjes, pra se si caktohet juridiksioni dhe kompetenca, parimi i veprimit të ligjit procedural në kohë gjen pasqyrim në nenet 36/5 dhe 41/2 të ndryshuara të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilave kompetenca dhe juridiksioni përcaktohet në momentin e paraqitjes së padisë, pavarësisht ndryshimeve të mëpasshme të faktit apo të ligjit...".

123. Në përfundim të hetimit administrativ, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve si vijojnë: vërehet se shtyrjet e seancave kryesisht kanë ardhur për shkaqe objektive si pasojë e kërkesave të palëve dhe mosparaqitjes së tyre, paraqitjes së provave, zëvendësimit procedural, por disa seanca përgatitore duket se janë shtyrë për shkak të subjektit të rivlerësimit, pasi:(a) është e paqartë shtyrja e seancës përgatitore e datës 24.4.2019 me qëllim verifikimin e taksës së padisë, pasi në vendimin e veprimeve paraprake, datë 7.3.2019 subjekti e ka vlerësuar padinë me pa të meta; (b) në seancën e datës 29.5.2019, është pasqyruar se në seancën e kaluar (15.5.2019) është bërë zëvendësimi procedural, ndërkohë, vendimi për zëvendësimin procedural është i datës 30.5.2019. Përveç kësaj, sa i takon kësaj çështjeje duket se: (i) procesverbalet e seancave gjyqësore nuk janë të nënshkruara nga subjekti i rivlerësimit sipas parashikimit të nenit 118⁵⁹ të Kodit të Procedurës Civile; (ii) deklarimi i moskompetencës lëndore është bërë pasi gjykata është tërhequr për të dhënë vendimin përfundimtar⁶⁰, ndërkohë që një veprim i tillë parashikohet të kryhet gjatë veprimeve paraprake⁶¹ të gjyqtarit; (iii) pretendimi i denoncuesit për shkelje të ligjit në deklarin e moskompetencës lëndore është konstatuar edhe nga Gjykata e Lartë. Në lidhje me pretendimin e denoncuesit se subjekti i rivlerësimit vepron me dy standarde, duket se në një rast të ngjashëm, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar moskompetencën lëndore [shihni vendimin nr. ***, datë 9.2.2018, dhënë nga subjekti i rivlerësimit, trajtuar tek denoncimi nga ***].

124. Në parashtrimet e saj, subjekti parashtrio si vijon:

⁵⁹ "Nëse procesverbali mbahet në formë të përmbledhur me shtypshkrim apo dorëshkrim, ai nënshkruhet në fund të çdo faqeje nga sekretari dhe në fund të dokumentit nga kryetari i seancës, menjëherë pas seancës, dhe përfshihet në dosjen gjyqësore".

⁶⁰ Neni 305 i Kodit të Procedurës Civile: "Pasi palët kanë parashtruar përfundimet e kërkesat e tyre, gjykata deklaron tërheqjen e saj në dhomën e këshillimit, për të dhënë vendimin përfundimtar".

⁶¹ Neni 158/a i Kodit të Procedurës Civile: "Në rast se nga studimi paraprak i akteve, gjyqtari konstaton mungesën e juridiksionit ose kompetencës, ose palëve u mungon zotësia për të vepruar ose përfaqësimi është në kundërshtim me ligjin, atëherë ai duhet përkatësisht të vendosë nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, dërgimin e çështjes për gjykim gjykatës kompetente, disponon me vendim, sipas parashikimeve të këtij Kodi, ose i cakton afat palëve për të rregulluar aktet e përfaqësimit".

- Në lidhje me zvarritjen e procesit, sqaron se nga data e regjistrimit të kërkesëpadisë 16.2.2019 dhe deri në datën e dhënies së vendimit 20.12.2019, çështja ka zgjatur 10 muaj e 4 ditë. Gjatë kësaj kohe janë zhvilluar 11 seanca dhe vetëm në një rast shkak për shtyrjen e seancës gjyqësore ka qenë mungesa e magjistratit dhe kjo për arsye plotësisht objektive. Nga ana tjetër subjekti deklaron se nga data e shpalljes së moskompetencës nga ana e saj deri në marrjen e vendimit nr. *** të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, datë 19.4.2022, kanë kaluar 2 vjet e 4 muaj pa u zhvilluar asnjë seancë. Siç vërehet subjekti do të thotë që e ka mbajtur çështjen vetëm 10 muaj, ndërsa gjykata administrative e ka mbajtur mbi 2 vjet. Prandaj, sipas saj, nuk e ka zvarritur çështjen krahasuar me gjykatën administrative. Në këtë mënyrë subjekti sjell në vëmendje parimin e proporcionalitetit dhe të barazisë mes palëve. Sipas subjektit, ankesa e z. A. B. është inspektuar dhe verifikuar nga ILD-ja, i cili me vendimin nr. ***, datë 19.11.2021, ka vendosur “arkivimin e ankesës”, si dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, i cili me vendimin nr. *** prot., datë 20.4.2022, ka vendosur refuzimin e ankimit të shtetasit A. B.

- Sa i takon konstatimit në pikën (i), mban të njëjtin qëndrim si në raste të tjera të kësaj natyre. Sa i takon konstatimit në pikën (ii), sipas subjektit legjislatori ka parashikuar në nenin 59 së gjykata në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit, qoftë edhe kryesisht, merr në shqyrtim nëse çështja që shqyrton bën pjesë në juridiksionin gjyqësor apo atë administrativ. Subjekti shprehet se kundër vendimit të dhënë për një rast të tillë, mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Lartë, duke cituar edhe parashikimet e neneve 60, 62, 63 dhe 64 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe nenin 13 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, se: *1. Moskompetenca lëndore dhe funksionale ngrihet edhe kryesisht në çdo gjendje e shkallë të shqyrtimit*. Në këtë arsyetim, sipas subjektit deklarimi i moskompetencës konform nenit 59 të Kodit të Procedurës Civile mund të merret në çdo shkallë e fazë gjykimi, por pavarësisht kësaj, vendimi nr. 887 i Gjykatës së Lartë e ka zgjidhur në mënyrë përfundimtare këtë konflikt duke rregulluar kompetencën lëndore. Sipas subjektit, diskutimi dhe barra e provës në lidhje me këtë konstatim është çështje këndvështrimi dhe aplikim i dispozitës. Për këtë arsye ligji ka parashikuar që në raste të tilla, konfliktet e kompetencës i zgjidh Gjykata e Lartë brenda një kohe të shkurtër duke përcaktuar gjykatën kompetente. Sa i takon konstatimit në pikën (iii), subjekti i rivlerësimit nuk dha sqarime.

- Në mbështetje të parashtrimeve, subjekti paraqiti disa dokumente shkresore.

125. Në një vlerësim të parashtrimeve dhe dokumenteve që subjekti paraqiti, vlerësohet se:

- Sa i takon konstatimeve në pikat (a) dhe (b) argumentet e subjektit nuk janë të plota dhe bindëse në lidhje me zvarritjen e procesit për një çështje me objekt marrëdhënie pune jokomplekse. Sjellja në vëmendje nga ana e subjektit e parimit të proporcionalitetit dhe barazisë mes palëve me argumentin se çështja ka zgjatur 10 muaj e 4 ditë, ku janë zhvilluar 11 seanca, në një kohë që nga data e shpalljes së moskompetencës deri në marrjen e vendimit nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, datë 19.4.2022, kanë kaluar 2 vjet e 4 muaj pa u zhvilluar asnjë seancë, nuk justifikon zvarritjen e procesit, pasi subjekti edhe pas zhvillimit të 11 seancave nuk ka identifikuar saktë natyrën e mosmarrëveshjes që i shtrohet për gjykim, së cilës duhet t’i referohet për përcaktimin e kompetencës lëndore.

- Sa i takon mungesës së nënshkrimit të procesverbaleve, është një rast i përsëritur që tregon mangësi në aspektin e aftësive organizative sipas parashikimeve të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016.

- Sa i takon konstatimit në pikën (ii) nga ana e Komisionit vlerësohet se subjekti përpiqet të paraqesë argumente ligjore se moskompetenca lëndore mund të shpallet në fazë të gjykimit, por nuk dha asnjë argument se përse një veprim i tillë nuk është kryer në fazën e studimit paraprak të akteve, sipas nenit 158/a të Kodit të Procedurës Civile, apo cilat fakte apo rrethana pas përfundimit të hetimit gjyqësor ishin të ndryshme nga faza e studimit paraprak të akteve, që çuan në konstatimin e mungesës së kompetencës lëndore. Arsyetimi i subjektit se konform

nenit 59 të Kodit të Procedurës Civile⁶² deklarimi i moskompetencës mund të merret në çdo shkallë e fazë gjykimi, në rastin konkret gjendet i pavend pasi, së pari kjo dispozitë i referohet juridiksionit dhe jo kompetencës lëndore, dhe së dyti, në vendimin e dhënë vetë subjekti ka përdorur si bazë ligjore nenin 61 të Kodit të Procedurës Civile. Në vijim të këtij arsytimi, gjendet i pavend qëndrimi i subjektit se barra e provës në lidhje me këtë konstatim është çështje këndvështrimi dhe aplikim i dispozitës⁶³, nisur edhe nga fakti që subjekti i rivlerësimit nuk dha asnjë sqarim apo nuk mbajti një qëndrim mbi konstatimin se në rastin e trajtuar në denoncimin ***, subjekti nuk ka deklaruar moskompetencë lëndore.

Denoncim nga shtetasi Z. L.⁶⁴

126. Ky denoncues pretendon proces të njëanshëm pasi subjekti ka shtyrë 4 seanca me arsyetimin se nuk është paraqitur prokurorja dhe pse kjo e fundit kishte marrë dijëni, dhe se, nga dhënia e vendimit deri në dërgimin në sekretari të vendimit i ka shkelur të drejtat pasi kërkesa duhet të shqyrtohej brenda 5 ditëve sipas nenit 260 të Kodit të Procedurës Penale. Gjatë procesit të hetimit administrativ, subjekti dha sqarime shoqëruar me dokumentacion⁶⁵, mbi pretendimet e ngritura nga denoncuesi që kanë të bëjnë me çështjen që i përket vendimit nr. ***, datë 7.1.2019, nga analizimi i të cilave Komisioni konstatoi se pretendimet e denoncuesit nuk qëndrojnë, pasi nisur nga printimet e procesverbaleve të seancave, çështja është marrë në shqyrtim brenda afatit 5-ditor. Me njoftimin e rezultateve të hetimit administrativ iu kërkua subjektit të paraqesë procesverbalet e çështjes që i përket vendimit nr.***, datë 7.1.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

127. Në parashtrimet e veta, subjekti pretendon se procesverbali i seancës është sjellë pranë Komisionit, por nuk paraqiti ndonjë dokument bashkëlidhur. Pra, duket se subjekti i referohet procesverbaleve të paraqitura në përgjigje të pyetësorit nr. 2, të cilat janë printime të panënshkruara nga sekretarja dhe subjekti, rast i përsëritur dhe që është konsideruar si mangësi organizative.

Denoncim nga shtetasi K. P.⁶⁶

128. Ky denoncues ngre pretendime që kanë të bëjnë me vlerësimin e provave, vendimmarrjen, zvarritje të gjykimit të përfunduar me vendimin nr. ***, datë 17.11.2015, si dhe paaftësi profesionale të gjyqtarës Izabela Radovani. Ai pretendon se janë zhvilluar 36 seanca dhe dyshon se janë fshirë procesverbalet e seancave 6.5, 27.5, 17.6, 8.7, 23.7.2014, nisur nga konstatimi i KLD-së se janë zhvilluar 31 seanca nga data 23.7.2014 deri më 17.11.2015.

129. Pas verifikimeve të kryera nga Komisioni, të bëra me dije subjektit në rezultatet e hetimit administrativ, duket se ka zvarritje të procesit nga subjekti i rivlerësimit, si dhe mangësi në dokumentacionin e dosjes pasi: (i) nga data e shortit 31.3.2014 deri në përfundimin e procesit datë më 17.11.2015 çështja ka zgjatur 1 vit e 7 muaj e 17 ditë, pra përtej afatit 6-mujor sipas Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit; (ii) në dosjen gjyqësore mungojnë procesverbalet e seancave të datave 6.5.2014, 27.5.2014, 17.6.2014, 8.7.2014 dhe 23.7.2014; (iii) mbetet i paqartë pasqyrimi në vendim sipas të cilit, në seancën përgatitore të datës 23.7.2014 shtetasi K. P. ka kërkuar përjashtimin e gjyqtarit, pasi denoncuesi ka paraqitur kopje vendimi nr. ***,

⁶² “Gjykata në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit, qoftë edhe kryesisht, merr në shqyrtim nëse çështja që shqyrton, bën pjesë në juridiksionin gjyqësor apo atë administrativ”.

⁶³ Neni 59 i Kodit të Procedurës Civile: “Gjykata në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit, qoftë edhe kryesisht, merr në shqyrtim nëse çështja që shqyrton, bën pjesë në juridiksionin gjyqësor apo atë administrative”. Kundër vendimit të dhënë për një rast të tillë, mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Lartë.

⁶⁴ Shihni denoncimin nr. *** prot., datë 14.2.2019 në dosjen e Komisionit.

⁶⁵(i) Vendim nr. ***, datë 7.1.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; (ii) kopje të kthim përgjigjes së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; (iii) printime të procesverbaleve të seancave; (iv) kopje vendimi nr. *** prot., datë 8.10.2021, të ILD-së, i cili ka trajtuar pretendimet e shtetasit Z. L. duke vendosur arkivimin e ankesës së tij; (v) dosjen gjyqësore me vendim nr. ***, datë 28.9.2018, verifikim mase sigurie me të pandehur Z. L. etj. dhe dosjen gjyqësore me vendim nr. ***, datë 1.4.2019, me objekt shuarje mase sigurie me të pandehur Z. L.

⁶⁶ Shihni denoncimin nr. *** prot., datë 22.7.2019, në dosjen e Komisionit.

datë 4.9.2014, me datë regjistrimi 22.7.2014, me objekt përjashtimin e gjyqtares Izabela Radovani; (iv) sipas procesverbalit datë 20.4.2015, subjekti i rivlerësimit ka vendosur të thërrasë ekspertin G. S., ndërkohë në seancë e radhës është paraqitur edhe eksperti M. H., por në dosje nuk rezulton asnjë vendim për caktimin e ekspertit M. H., apo të jetë pasqyruar në procesverbal; (v) disa seanca janë shtyrë për shkak se gjykata i ka dhënë detyra ekspertit, siç është marrja e gen planit pranë prokurorisë, kur një dokument i tillë mund të merrej me shkresë zyrtare nga gjykata; (vi) sipas procesverbalit të seancës gjyqësore datë 29.9.2015, subjekti i rivlerësimit ka shtyrë seancën gjyqësore me shkakun se nuk u paraqit eksperti M. H. ndërkohë, po sipas këtij procesverbali, ky ekspert ka dhënë shpjegime në këtë seancë; (vii) mbetet e paqartë arsyeja e thirrjes së ekspertit G. S. pa dhënë asnjë argument se përse është e nevojshme dhe përse ishte e pavlefshme ekspertiza e ekspertit S. C., pasi ky i fundit kishte deklaruar se e kishte përfunduar aktin, si dhe vetë gjykata ka relatuar se eksperti ka plotësuar aktekspertimin sipas detyrave të lëna nga gjykata; (viii) në dosjen gjyqësore mungon vendimi për pezullimin e gjykimit; (ix) KLD-ja ka konstatuar se gjykimi është zvarritur dhe shkakun kryesor ka qenë organizimi i keq i punës nga gjyqtarja Izabela Radovani, e cila ka manifestuar mangësi të theksuara profesionale në këtë gjykim.

130. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e këtyre konstatimeve.

131. Në parashtrimet e saj, subjekti deklaroi se:

- Denoncuesi K. P. duke mos qenë dakord me vendimin për zgjidhjen e themelit të çështjes, e ka apeluar vendimin duke ngritur një sërë shkaqesh në këtë ankim. Me vendimin nr. ***, datë 12.10.2016, Gjykata e Apelit Shkodër, pasi ka hetuar çdo pretendim, ka vendosur të mos e pranojë ankimin dhe të lërë në fuqi vendimin nr. ***, datë 12.10.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Siç vërehet, subjekti i rivlerësimit përpiqet të kundërshtojë barrën e provës me argumentin se Gjykata e Apelit ka hetuar pretendimet e denoncuesit, të cilat nuk i ka gjetur të bazuara, duke lënë në fuqi vendimin e dhënë nga subjekti. Sipas subjektit, Gjykata e Apelit në thelb ka trajtuar pretendimet e denoncuesit mbi vlerësimin e provave apo themelin e çështjes duke i gjetur të pabazuara, por as Komisioni nuk i ka kaluar barrën e provës subjektit për këto çështje. Nga përmbajtja e vendimit të Gjykatës së Apelit nuk rezulton të jenë trajtuar konstatimet e Komisionit.

- Në lidhje me faktin se KLD-ja ka konstatuar se gjykimi është zvarritur dhe shkakun kryesor ka qenë organizimi i keq i punës nga gjyqtarja Izabela Radovani, e cila ka manifestuar mangësi të theksuara profesionale në këtë gjykim, subjekti deklaroi se ky është i vetmi konstatim i bërë nga çdo verifikim/kontroll/ankesë apo denoncim të bërë në lidhje me punën dhe profesionalizmin e saj dhe në këtë rast KLD-ja e ka çmuar se nuk ka vend për vërejtje apo masë ndaj magjistratit. Pretendimi se ndaj saj nuk është marrë ndonjë masë ndaj subjektit qëndron, pasi nuk u konstatua një fakt i tillë.

132. Në përfundim, Komisioni çmon se në tërësinë e parashtrimeve, subjekti nuk paraqiti argumente bindëse apo prova për të provuar të kundërtën e konstatimeve, që në mënyrë të përmbledhur kanë të bëjnë me zvarritje të procesit, keqorganizimin e procesit gjyqësor, seanca gjyqësore joproductive, rregullshmërinë, plotësinë dhe saktësinë e dokumentacionit të dosjes, si dhe mangësi të theksuara profesionale në këtë gjykim, siç ka konkluduar edhe KLD-ja në verifikimin e kësaj çështjeje. Për pasojë, edhe në gjykimin e çështjes objekt verifikimi, subjekti ka treguar mangësi organizative.

133. Sa i takon pretendimit në lidhje me vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit, bazuar në pikën 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerësohet se nuk është në kompetencën e Komisionit të gjykojë mbi korrektësinë e vendimit dhe themelit të çështjes, tagra këto të cilat janë në kompetencë të një gjykate më të lartë.

Denoncim nga shtetasi D. P.⁶⁷

134. Ky denoncues pretendon se qëndrimi i gjyqtares Izabela Radovani ka vënë në pikëpyetje institutin e dorëheqjes së gjyqtarit për shkak të qëndrimeve subjektive.

135. Pas verifikimeve të kryera nga Komisioni, të bëra me dije subjektit me njoftimin e rezultateve të hetimit administrativ, iu kërkua subjektit të japë sqarime të plota dhe shteruese mbi pretendimet e denoncuesit, shoqëruar me dokumentacion provues si, kërkesëpaditë e paraqitura nga denoncuesi shoqëruar me kontrata noteriale, kërkesë për heqje dorë të subjektit të rivlerësimit, shoqëruar me vendimin përkatës ose vendimin e gjykatës për përjashtimin e saj, për çështjen ku denoncuesi ishte si palë e paditur dhe në tjetrën ku ishte si palë paditëse.

136. Në parashtrimet e saj subjekti nuk dha sqarime, por u ndal vetëm në faktin se paraqet vendimet në lidhje me kërkesat për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes të pretenduara nga denoncuesi, si dhe vendimmarrjet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, si dhe vendimin nr. ***, datë 8.4.2022, të ILD-së “për arkivimin e ankimit të z. D. P.”.

137. Nga analizimi i parashtrimeve dhe provave të paraqitura vërehet se sa i takon pretendimeve të denoncuesit për çështjen ku ai është palë e paditur, nisur nga dokumentacioni i paraqitur, nga ana e Komisionit vlerësohet se nuk qëndrojnë, ndërsa sa i takon çështjes ku denoncuesi është palë paditëse, subjekti nuk dha sqarime, si dhe nuk paraqiti ndonjë dokumentet për heqje dorë apo kërkesë për përjashtim nga kjo çështje.

Denoncimet në media

Denoncim nga emisioni *⁶⁸**

138. Sipas këtij denoncimi, shtetasi N. B. pretendon se në një proces gjyqësor për çështje pronësie, gjyqtarja Izabela Radovani thirri topografin E. K. Shtetasi N. B. u interesua në drejtorinë e rregullimit të lejeve dhe licencave dhe mori përgjigje se shtetasi E. K. nuk mund të ushtrojë profesionin e tij, për shkak të mbarimit të afatit të licencës. Shkresa iu vu në dispozicion gjyqtares, por ajo nuk e mori në konsideratë, ndaj çështja shkoi në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

139. Me njoftimin e rezultateve të hetimit administrativ, iu kërkua subjektit të japë sqarime mbi pretendimet e ngritura nga shtetasi N. B. në media, shoqëruar me dokumentacion shkresor.

140. Në parashtrimet e saj, subjekti sqaroi se qëndrimi i mbajtur gjatë gjykimit të këtij rasti nga ana e saj është tejet ligjor dhe në përmbushje të rregullt të detyrës, pa shkelje të dispozitave materiale dhe procedurale. Subjekti i referohet vendimit nr. 14.12.2022 të Gjykatës së Apelit Shkodër, vendim i cili ka lënë në fuqi vendimin nr. s’ka, datë 29.4.2022, si dhe kërkesës për pushimin e procedimit penal, datë 7.11.2022, të P rokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Subjekti sqaroi se kjo çështje gjyqësore aktualisht nuk ndiqet dhe nuk gjykohet nga ajo për shkak të heqjes dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje, kërkesë e cila është pranuar nga Kryetari i Gjykatës.

141. Në mbështetje të sqarimeve, subjekti paraqiti: kërkesë për heqje dorë nga gjykimi i çështjes me palë të paditur N. B. etj., me arsyetimin se pala e paditur ka humbur besimin në këtë trup gjykues etj., kërkesë e cila është pranuar nga zv/kryetari i gjykatës datë 12.12.2022; kopje procesverbali të datës 24.11.2022, ku rezulton se eksperte është caktuar E. S.; vendim nr. ***, datë 14.12.2022, i Gjykatës së Apelit Shkodër, i cili ka lënë në fuqi vendimin nr. s’ka, datë 29.4.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me të cilin është vendosur pezullimi i gjykimit të çështjes me palë të paditur N. B. etj.; kërkesë e Prokurorisë për pushimin e procedimit penal nr. 48/2020 që ka të bëjë me pretendimet e denoncuesit ndaj ekspertit E. K.

⁶⁷ Shihni denoncimin nr. *** prot., datë 28.7.2021 dhe shkresën nr. *** prot., datë 22.11.2022, të MD-së në dosjen e Komisionit.

⁶⁸<https://stop.tvklan.al/stop-emisioni-162sezoni-5-14-prill-2020-shkoder-gjyqtarja-merr-topografin-pa-license-per-ceshtje-pronesie/>

për falsifikim të dokumenteve. Në përfundim të hetimeve prokurori i çështjes ka konkluduar se duhet të pushohet procedimi penal, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, por pa paraqitur dokumentacion se çfarë është vendosur nga gjykata në lidhje me këtë kërkesë të prokurorit.

142. Nga analiza e parashtrimeve dhe dokumenteve të paraqitura nga subjekti, për sa kohë provohet se në këtë çështje tashmë nuk është ekspert E. K., por E. S., si dhe fakti që për të shmangur çdo paanshmëri, subjekti ka kërkuar heqjen dorë nga gjykimi i çështjes, kërkesë e cila është pranuar nga zv/kryetari i gjykatës, nga ana e Komisionit sqarimet e subjektit vlerësohen si të bazuara.

Denoncim nga emisioni *⁶⁹**

143. Sipas këtij denoncimi A. B. denoncon hallën e saj Izabela Radovani, gjyqtare në Shkodër, duke pretenduar se halla ka vjedhur shtëpinë e të vëllait, babait të saj të ndjerë. Vajza dhe djali i të ndjerit A. B., që jetojnë prej 25 vitesh jashtë Shqipërisë, mësuan këtë fakt pas një jave që babai kishte ndërruar jetë. Ata u vunë në dijeni se babai i tyre ia kishte dhuruar pjesën e tij nipit G. R., djalit të gjyqtares, pa pëlqimin e djalit të tij si bashkëpronar. Gjithashtu pretendohet që kontrata e dhurimit që i ndjeri A. B. i bëri nipit, është firmosur me shenjë gishti, kur i ndjeri ka qenë me shkollë të mesme dhe mund të firmoste vetë. Fëmijët dyshojnë se shtëpia është marrë përmes një kontrate të parregullt. Apartamenti tani është dhënë me qira dhe pagesën e merr shtetasi G. R., djali i gjyqtares Izabela Radovani.

144. Me njoftimin e rezultateve të hetimit iu kërkuua subjektit të japë sqarime mbi pretendimet e ngritura nga shtetasja A. B. në media duke shoqëruar me dokumentacion shkresor.

145. Në parashtrimet e saj, subjekti kërkoi që duke qenë një rast familjar dhe personal i bërë publik, sqarimet të bëhen vetëm nëpërmjet provave duke ruajtur kështu privatësinë e marrëdhënieve familjare të saj. Sipas subjektit, pasuria e pretenduar nga denoncuesja A. B. i është shitur me kontratë noteriale shitjeje nr. ***, datë 14.3.2003 kundrejt pagimit të çmimit, babait të saj, të ndjerit A. B. Ky i fundit, me kontratën e dhurimit nr. ***, datë 14.3.2022, pjesën e vet takuese të pasurisë e ka disponuar duke ia dhuruar nipit të tij, djalit të subjektit G. R., për arsytet e përmendura në atë kontratë. Subjekti shpjegoi se kjo pasuri në vetvete përbën një apartament të ndarë në disa numra pasurie dhe aktualisht është në bashkëpronësi të shtetasit G. R. dhe shtetasit E. B. – djalit të të ndjerit A. B.

145.1. Në lidhje me pretendimin se dhurimi është bërë “pa pëlqimin e djalit të tij si bashkëpronar” sipas subjektit, konform nenit 200/c të Kodit Civil, parashikohet se: *“Secili bashkëpronar ka të drejtë të tjetërsojë ose disponojë në çdo mënyrë tjetër pjesën e tij në sendin e përbashkët, por kur ky është një send i paluajtshëm, mund ta shesë pjesën e tij vetëm duke respektuar të drejtën e parablerjes që kanë bashkëpronarët e tjerë”*. Kështu, veprimi juridik në lidhje me “dhurimin” nuk kërkon dhënien e pëlqimit nga bashkëpronari, përpos kësaj, denoncuesja me shitjen e sendit ka humbur çdo të drejtë reale mbi sendin, ndërsa bashkëpronari E. B. nuk ka ngritur asnjë pretendim lidhur me sa më sipër.

145.2. Në lidhje me pretendimin se: “kontrata e dhurimit që i ndjeri A. B. i bëri nipit, është firmosur me shenjë gishti, kur i ndjeri ka qenë me shkollë të mesme dhe mund të firmoste vetë”, sipas subjektit, dokumentacioni i bashkëlidhur kontratës së dhurimit nr. ***, datë 14.3.2022 sqaron në mënyrë shteruese çdo pretendim. Pavarësisht sa është denoncuar në emisionin “***” një pretendim i tillë, subjekti i është drejtuar me kërkesë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, si dhe Prokurorisë së Rrethit Shkodër, nga ku rezultoi se nuk ka të regjistruar asnjë çështje civile apo denoncim nga shtetaset/palët S. B., A. B. ndaj Izabela Radovani dhe/apo G. R.

⁶⁹ <https://stop.tvklan.al/stop-emisioni-123sezoni-8-21-shkurt-2023-shkroi-emrin-por-firma-u-be-me-gisht-si-ia-mori-gjyqtarja-shtepine-vellait/>

146. Në mbështetje të sqarimeve subjekti paraqiti:

- Kontratë shitjeje të pasurisë nr. ***, datë 14.3.2003, sipas së cilës S. L. dhe A. A. B. i shesin shtetasit A. B. pasurinë nr. ***, si dhe pjesën takuese të pasurisë nr. nr. *** në bashkëpronësi të S. L., A. A. B., A. B. dhe E. B.

- Kontratë dhurimi pasurie e paluajtshme nr. ***, datë 14.3.2022, me palë dhuruese A. B. dhe pranues dhurimi G. R. Dhuruesi i dhuron pjesët e tij takuese konkretisht: 1. pasurinë nr. ***; 2. 3/4 pjesë të pasurisë nr. ***, ndërsa pjesa 1/4 mbetet në favor të shtetasit E. B.; 3. 1/2 pjesë të pasurisë nr. ***, ndërsa 1/2 mbetet në favor të shtetasit E. B. Në këtë kontratë dhuruesi deklaroi se i dhuron nipit të tij pjesën takuese mbi tri pasuritë si shenjë mirënjohjeje për të gjitha shërbimet e përkushtimet që ka bërë kjo familje për dhuruesin, i cili ka qenë për një periudhë të gjatë kohe i sëmurë dhe nuk ka mundur të bëjë pa këtë ndihmë.

- Shkresë nr. *** prot., datë 29.3.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër sipas së cilës nuk rezulton çështje civile me palë S. L. dhe A. B. ndaj I. R. dhe G. R., si dhe shkresë nr. *** prot., datë 29.3.2023, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, sipas së cilës nuk rezulton të jetë regjistruar kallëzim penal apo procedim penal me kallëzues S. L. dhe A. B. ndaj Izabela Radovani dhe shtetasit G. R.

147. Në një vlerësim të përgjithshëm të pretendimeve të ngritura nga denoncuesja dhe sqarimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti në parashtrimet e veta, në përfundim të procesit nga ana e Komisionit vlerësohet se pretendimet e shtetasës A. B., mbeten në nivel deklarativ.

Informacione të tjera

148. Ministria e Drejtësisë ka informuar se në lidhje me subjektin e rivlerësimit Izabela Radovani janë depozituar pesë ankesa. Nga verifikimi i ankesave vërehet se: (i) dy prej tyre, *** dhe D. P., janë paraqitur edhe pranë Komisionit të cilat janë trajtuar te denoncimet; (ii) për tri ankesa të shtetasve N. M., Sh. Rr. dhe P. M., ankuesit janë orientuar për zgjidhjen në organet përkatëse, për të cilat Komisioni vlerësoi se nuk përmbajnë fakte dhe rrethana që do të bënin të domosdoshme hetime të mëtejshme.

149. Prokuroria e Përgjithshme⁷⁰ ka përcjellë informacion nga prokuroritë e rretheve nga të cilat rezultoi se ndër të tjera, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, ndaj Izabela Radovani është regjistruar procedimi penal nr. ***, i cili është në hetim, si dhe, kallëzimi penal nr. *** i dërguar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, iu kërkua subjektit të japë sqarime për vijimësinë e tyre, duke provuar me dokumentacion shkresor.

150. Në parashtrimet e veta subjekti nuk dha sqarime për vijimësinë e procedimit dhe kallëzimit si më sipër dhe as ndonjë dokument për sa i është kërkuar, por ka paraqitur disa dokumente për çështje civile, gjykuar nga subjekti i rivlerësimit me palë paditëse B. D. dhe M. D. dhe i paditur shtetasi Z. S. dhe Bashkia Shkodër. Për rrjedhojë, këto rrethana do të mbahen në konsideratë në vlerësimin tërësor në raport me të gjitha rrethanat dhe mangësitë e tjera të evidentuara gjatë vlerësimit të aftësive profesionale.

Rivlerësimi profesional sipas kritereve të parashikuara në nenin 71 dhe vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

151. Në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale sipas kritereve të parashikuara në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, bazuar në të gjitha analizimet dhe vlerësimet për çdo çështje objekt verifikimi rast pas rasti trajtuar në këtë vendim, Komisioni vlerësoi se subjekti ka treguar aftësi profesionale sipas nenit 72 të

⁷⁰ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 8.7.2021, të Prokurorisë së Përgjithshme në dosjen e Komisionit.

ligjit nr. 96/2016, aftësi personale dhe angazhim profesional sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016. Sa i takon problematikave në drejtim të aftësive organizative parashikuar nga neni 74 i ligjit nr. 96/2016, etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale parashikuar nga neni 75 i ligjit nr. 96/2016, në një vlerësim tërësor të rrethanave si pasojave që kanë sjellë, natyrës së çështjeve të gjykuara apo ngarkesës në punë të subjektit të rivlerësimit, vlerësohet se ato nuk mjaftojnë për të kualifikuar subjektin të paaftë profesionalisht. Por këto problematika, në disa raste të përsëritura si dhe qëndrimi i subjektit në lidhje me mangësitë e evidentuara, e cila jo në pak raste ka dhënë parashtrime të përgjithshme të pabazuara në dokumente shkresore ose mungon të ketë dhënë deklarime/parashtrime/dokumente në lidhje me konstatimet e Komisionit, në një vlerësim tërësor të rrethanave dhe procedurave sipas pikës 3 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 dhe sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, janë marrë në konsideratë në vlerësimin përfundimtar në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

IV. SEANCA DËGJIMORE

152. Në datën 12.4.2023, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, u zhvillua seanca dëgjimore për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Izabela Radovani, në përfundim të së cilës, kërkoi konfirmimin në detyrë. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin e saj, duke dhënë sqarime të mëtejshme dhe prova mbi rezultatet e hetimit administrativ, procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, si dhe duke iu përgjigjur pyetjeve të drejtuar nga anëtarët e trupit gjykues. Në datën 14.2.2023 u zhvillua seanca, në të cilën Komisioni shpalli vendimin për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit I. H.

V. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

153. Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016, si dhe gjatë seancës dëgjimore. Edhe pse subjekti ka qenë bashkëpunuese dhe e gatshme në kthimin e përgjigjeve, në disa raste deklarimet e saj vijnë në kundërshtim me fakte e rrethana të deklaruara më parë prej saj apo të evidentuara nga Komisioni, ndërkohë, që në disa raste subjekti mungon të ketë dhënë shpjegime apo dokumente shkresore, trajtuar hollësisht në këtë vendim, qëndrim i cili është mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes, sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

VI. KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

154. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, gjatë bisedimeve për vlerësimin përfundimtar të çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të rivlerësimit, si dhe në një vlerësim tërësor të rrethanave të çështjes objekt rivlerësimi, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Izabela Radovani nuk arrin nivelin kualifikues për sa i takon kriterit të pasurisë sipas nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016, çka përbën shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, sipas parashikimit të pikës 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, bazuar në germën “c” të pikës 1 të nenit 58 dhe në pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Izabela Radovani, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 14.4.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Olsi KOMICI
Kryesues

Firdes SHULI
Relatore

Xhensila PINE
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Ertugena Sokoli